



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 11 TETOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 04.10.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Interpelancë me ministrin e Financave dhe të Ekonomisë, kërkuar nga deputeti Erion Braçe *(neni 96 i Rregullores)*

4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar” nismë e Këshillit të Ministrave *(nenet 28, 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar”, nismë e një

grupi deputetësh *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Njoftimi/miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën në vijim *(neni 26, pikat 5 dhe 6, i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

6. Njoftim/miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën në vijim *(neni 27, pikat 3 dhe 4, i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

7. Të bartura për votim:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

- Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)

- Projektvendimi “Për zgjedhjen e një anëtarit të Bordit të Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

8. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores)

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta.

Gramoz Ruçi - Mirëdita!

Të futen mediet.

Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Ka ndonjë vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Nga Këshilli i Ministrave janë depozituar tre projektligje, si dhe raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2017. Materialet do t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit në internet dhe në sistemin e-parlament.

Fillojmë me projektligjin për gjendjen civile dhe më pas me interpelancën.

Ka ndonjë nga nismëtarët që do ta marrë fjalën? Nuk ka.

Nga komisioni përkatës? Nuk ka.

Atëherë fillojmë me diskutimet.

Kanë regjistruar emrat për të diskutuar deputetët: Vasilika Hysi, Elisa Spiropali, Nuri Belba, Taulant Balla, Antoneta Dhima, Vilma Bello, Bujar Çela, Milva Ekonomi dhe Ulsi Manja në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Fjalën e ka zonja Hysi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Taulant Balla – Meqenëse ministri është prezent, a mund të vazhdojmë me interpelancën dhe më pas me ligjin për gjendjen civile?

Gramoz Ruçi – Zoti Balla, unë e kalova këtë pikë, sepse nuk ishte ministri prezent, por, në qoftë se zoti Braçe dhe ministri janë gati, vazhdojmë me interpelancën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Muaji shkurt është larg.

Fillojmë me interpelancën e kërkuar nga zoti Braçe me ministrin e Financave dhe të Ekonomisë për të diskutuar ligjshmërinë nga pikëpamja fiskale në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, si dhe nga ligji nr. 79\2017 “Për raportin e Federatës Shqiptare të Futbollit”.

Në mbështetje të nenit 96 të Rregullores, zoti Braçe do të parashtrojë interpelancën deri në shtatë minuta.

Fjala është për ju, zoti Braçe.

Erion Braçe – Faleminderit, i nderuar Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në nenin 155 të saj thuhet: “Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare dhe vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohet me ligj. Në këto raste ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese”.

Pra, është e qartë prej Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë se nuk ka asnjë autoritet politik, ekzekutiv, në nivel të lartë, duke filluar nga ministri, apo në nivel të ulët, deri te një inspektor i organeve fiskale, që të përjashtojë nga detyrimi i pagimit të tatimeve dhe taksave cilindo individ, shoqëri apo shoqatë, që është subjekt i ligjit dhe i ligjeve fiskale të këtij vendi. Zero. Nuk ka.

Kushtetuta ka vendosur kështu parimin e barazisë fiskale për cilindo subjekt të ligjit. Ligjshmëria fiskale e cilitdo subjekt, individ, shoqëri apo shoqatë, është thelbi i kësaj barazie: të trajtuarit njësoj ligjërisht, në zbatim dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara me ligje të votuara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, autoriteti i vetëm që vendos këtu, në sallën e Kuvendit, me votë të deputetëve, jo vetëm nivelin e tatimeve dhe taksave, por në

krahun tjetër edhe rrethin e subjekteve që duhet t'u nënshtrohen këtyre detyrimeve fiskale.

Po e theksoj disa herë ligjin, sepse përmes zbatimit të tij ka një përpjekje të përbotshme, nga Europa në Afrikë dhe Amerikë për të luftuar evazionin fiskal dhe pabarazinë, që vjen dhe rritet nga zbatimi selektiv i ligjit ndër subjektet e tij që kanë detyrime për të paguar tatime dhe taksa.

Përpjekja ka shënjestruar kudo në mënyrë të qartë shembuj të rëndësishëm për të krijuar dhe shpërndarë modele të barazisë fiskale apo ndëshkimit në emër të ligjit dhe të barazisë fiskale.

Po rendis disa raste apo shembuj:

Uli Hënes, kampion bote dhe president i Bayern Munich-ut, është dënuar me 3,5 vjet burg për evazion fiskal dhe mori mbi kurriz edhe detyrimin për të paguar 18,5 milionë euro detyrime tatimore, të cilave u ishte shmangur në kohë të ndryshme; Kristiano Ronaldo sapo është dënuar me 2 vjet burg dhe me detyrimin për të paguar 18,8 milionë euro për shmangie fiskale gjatë periudhës që luante në Spanjë; Jose Mourinho, trajneri me nam i Realit të Madridit dhe Manchester United, është dënuar me 1 vit burg dhe me detyrimin për të paguar 1,78 milionë paund për shkak të shmangieve fiskale gjatë kohës që ishte në Spanjë; Lionel Mesi është dënuar me 21 muaj burg dhe me detyrimin për të paguar 5 milionë euro për shkak të shmangieve fiskale gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij dhe realizimit të të ardhurave në Spanjë. Për të vazhduar me Neymar, i cili është dënuar me 1,2 milionë euro për shkak të shmangieve fiskale; Radamel Falcao edhe ky i dënuar me 4,8 milionë paund për shkak të shmangieve fiskale; Javier Mascherano është dënuar me 1,3 milionë euro për shkak të shmangieve fiskale; Xabi Alonso është dënuar me 2,6 milionë euro për shkak të shmangieve fiskale; Aleksis Sanchez i dënuar me 16 muaj burg dhe 1 milion euro për shkak të shmangieve fiskale; Grigori Surkis, zëvendëspresidenti i UEFA-s, është një personazh që këtu në Tiranë e pritën me temena të madhe si personalitet i madh, ndërkohë që është subjekt i hetimeve penale dhe i gjykrimeve për shkak të kriminalizimit si president i një ekipi futbollit në Ukrainë dhe, natyrisht, i është ndaluar rreptësisht për të hyrë në Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, si individ që mban mbi kurriz korrupsion dhe evazion fiskal.

I përmenda të gjitha këto raste për të sjellë në vëmendje se nga Gjermania që udhëheq Europën dhe deri te Spanja, që është njëra nga modelet më strikte të betejës kundër evazionit fiskal, ka shembuj të qenësishëm, ku ligjshmëria fiskale dhe barazia fiskale marrin një vlerë themelore. Po në Shqipëri?

Dua të mbetem te fusha e sportit. Federata Shqiptare e Futbollit është një nga institucionet më të rëndësishme në këtë vend, e cila organizon gara të rëndësishme dhe përfaqëson flamurin e këtij kombi në aktivitete ndërkombëtare. Pa më të voglin diskutim, ky duhet të ishte institucioni që të reflektonte jo vetëm ligjshmëri fiskale, por të ishte edhe model i qenësishëm i respektimit të ligjeve fiskale në këtë vend.

Që nga muaji shkurt kam kërkuar informacione për ligjshmërinë fiskale të këtij institucioni, por të them të drejtën që nga muaji shkurt nuk kam marr një përgjigje të qartë për përputhshmërinë me ligjin të aktivitetit të Federatës Shqiptare të Futbollit në aspektin fiskal. Kjo është arsyeja përse jam këtu dhe pretendoj një përgjigje të qartë nga ministri i fushës pikërisht për këtë fakt.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Braçe!

Shpresoj të merrni një përgjigje shteruese lidhur me shqetësimin tuaj. Ftoj ministrin e Financave, zotin Ahmetaj, të marrë fjalën.

Sipas nenit 96, pika 5, e Rregullores, keni fjalën deri në 20 minuta.

Arben Ahmetaj – Një interpelancë si kjo besoj se është një rast shumë i mirë për të bërë dallimin mes qeverive, të vitit 2013 dhe “Rama 1” dhe “Rama 2” për atë çka është bërë për sportin.

Struktura ligjore, për sa u përket sporteve në tërësi, por sidomos futbollit dhe pjesës së pronësisë, e cila është konfuze, pjesës së sponsorizimeve dhe pjesës së promovimit të mbështetjes së sportit, ka sjellë në rastin më të mirë një konfuzion dhe në shumë raste kaos në klubet sportive, sidomos në klubet e futbollit në Republikën e Shqipërisë.

Duke iu referuar kërkesës për interpelancë, më duhet të them që kërkesa ka qenë e gjerë dhe për këtë arsye më jep mundësinë të flas gjerësisht, por brenda kësaj mundësie ka edhe

detaje, që besoj se do të hedhin dritë mbi situatën e klubeve të futbollit dhe aktivitetin e Federatës Shqiptare të Futbollit.

Ne kemi në dorë ligjin e sportit, i cili ka marrë mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave, një iniciativë e drejtpërdrejtë e Kryeministrit për të qartësuar situatën e pronësisë, të mbështetjes financiare, të përgjegjësisë, qoftë të bashkive dhe presidentëve të klubeve, e cila do të ndihmojë edhe për transparencën dhe formalizmin e mëtejshëm në këtë fushë.

Federata Shqiptare e Futbollit sot, për shkak të mbështetjes së drejtpërdrejtë buxhetore dhe ligjore të qeverisë “Rama 1”, ka tre stadione të reja: i Elbasanit, i Shkodrës dhe kompleksi sportiv i Tiranës.

Stadione në këtë vend janë ndërtuar vetëm në kohën e Enverit, kështu i referohemi vitit 1980. Që nga ajo ditë janë ndërtuar stadione vetëm me mandatin “Rama 1” dhe vazhdojnë në “Rama 2” dhe jam i bindur që do të vazhdojnë edhe në mandatin “Rama 3”. Kjo është ajo që e ndan këtë maxhorancë nga ajo e kaluara, që është opozita e sotme, në vëmendjen ndaj sportit.

A ka hapësirë për të bërë më shumë për sportin? Patjetër. Futboli, peshëngritja dhe shumë sporte të tjera janë krenaria e Shqipërisë. Kemi qenë ne, majtas dhe djathtas, të emocionuar kur ekipi ynë kombëtar në Francë bëri atë paraqitje spektakolare dhe ishte kjo maxhorancë, kjo qeveri dhe ky Kryeministër që menjëherë me fitoren e asaj dite i akordoi kombëtares një pagesë prej 1 milion eurosh, për të treguar vlerësimin që edhe nëpërmjet këtyre instrumenteve dhe sportit dinjiteti kombëtar ka mundësi të rritet. Këtu besoj se është thembra e Akilit, në kuptimin e mbështetjes së shtetit për të rritur dinjitetin e qytetarëve shqiptarë dhe dinjitetin e vendit.

Ka emra të njohur në fushën e futbollit dhe jo vetëm, të cilët sot në Europë, si në aspektin e lojtarëve në fushë, ashtu edhe në aspektin e teknikëve në bankinë i bëjnë nder vendit. Igli Tare është një nga teknikët më të mirë në botë sot. Ai është një ish-lojtar i kombëtares dhe një qytetar dinjitoz shqiptar.

Federata Shqiptare e Futbollit dikur ka qenë një institucion pa zë, flas përpara 10 vjetësh, për shkak të situatës së futbollit, ndërsa sot është në fokus nga mbështetës dhe kritikë, ashtu duhet të

jetë, sepse edhe vëmendja ndaj sportit është rritur ndjeshëm.

Çfarë është Federata Shqiptare e Futbollit në aspektin fiskal? Federata është regjistruar në organin tatimor në datën 08.08.1996. Ajo ka statusin e organizatës jofitimprurëse dhe në organin tatimor deklaron tatimin mbi të ardhurat personale, kontributet e sigurimeve, TVSH-në për veprimtarinë e shitjeve që ushtron dhe tatime të tjera që i mban në burim në bazë të ligjit.

Të ardhurat dhe shpenzimet e FSHF-së në vite janë: në vitin 2014 të ardhurat kanë qenë 835 milionë lekë, ndërsa shpenzimet 930 milionë lekë. Si të gjitha institucionet shqiptare në atë vit, edhe Federata ka detyrime të prapambetura; në vitin 2015, të ardhurat kanë qenë 2,4 miliardë lekë dhe shpenzimet 2,6 miliardë lekë, përsëri me rris; në vitin 2016 të ardhurat kanë qenë 3,292 miliardë lekë dhe shpenzimet 2,612 miliardë lekë; në vitin 2017 të ardhurat kanë qenë 1,787 miliardë lekë dhe shpenzimet 1 miliardë e 395 milionë lekë. Këtu kam edhe pasqyrat e plota financiare të dorëzuara nga Federata Shqiptare, që mund të konsultohen faqe më faqe, kategori për kategori dhe zë për zë.

Për vitin 2017, të ardhurat totale, sipas strukturës, janë si më poshtë:

të ardhurat nga shitjet në vitin 2017 materiale sportive 11 milionë e 58 lekë; e drejta televizive për ekipin kombëtar nga UEFA 340 milionë e 463 lekë; e drejta televizive për kategorinë superiore 68.5 milionë lekë; reklama 20 milionë e 307 lekë; bileta për ndeshje futbollit 53 milionë e 607 lekë; kurse UEFA 20 milionë e 373 lekë; qira për fusha stadiumesh 26 milionë e 752 lekë. Pra, totali i të ardhurave në këtë kategori nga shitjet është 541 milionë e 113 mijë lekë.

Kategoria e dytë e të ardhurave nga klubet e futbollit, është 72 milionë e 769 mijë lekë; kartonë federimi 1 milion e 867 mijë lekë; kuota anëtarësimi 10 milionë e 700 mijë lekë; kontribute pagesash për gjyqtarët 41 milionë e 37 lekë; sponsorizime dhe donacione 196 milionë e 893 mijë lekë; grantet të ardhura në bazë të ligjit të kontabilitetit ndër vite, në vitin 2017 kanë qenë 838 milionë e 139 lekë nga UEFA, nga qeveria shqiptare dhe nga FIFA, grante nga qeveria për stadiumin 133 milionë vetëm për vitin 2017; rimarrje provigjone, që

është koncept legal dhe kontabël, janë 4 milionë e 838 mijë lekë. Totali është 1.25 miliardë lekë.

Për vitin 2017 shpenzimet, sipas strukturës, janë si më poshtë:

Paga 92 milionë e 644 mijë lekë, sigurime të paguara 11 milionë e 45 mijë lekë, amortizim 108 milionë e 117 mijë lekë, shpenzime të tjera 1 miliard e 176689 mijë lekë.

Federata Shqiptare e Futbollit ka në organikë 72 punonjës. Listëpagesa e gushtit të vitit 2018 është: Ilir Shulku, sekretar i Përgjithshëm, e ka pagën bruto 522 mijë lekë, paguan kontribute punëdhënësi 15 mijë e 878 mijë lekë dhe punëmarrësi 1056 dhe vazhdon listëpagesa e Federatës Shqiptare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm me të reja flitet. Të vjetrat nuk ekzistojnë me ligj.

Keni këtu listëpagesën e Federatës Shqiptare të Futbollit. Në 2014-ën, për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, Federata ka paguar 13 milionë e 423 mijë lekë, në 2015-ën 14 milionë e 867 mijë lekë, në 2016-ën 15 milionë e 282 mijë lekë, në 2017-ën 18 milionë e 575 mijë lekë, në 2018-ën deri në këtë periudhë, pra deri në fund të gushtit, ka paguar 12 milionë e 923 mijë lekë.

Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi: në 2014-ën ka paguar 5 milionë e 825 mijë lekë, në 2015-ën 6 milionë e 684 mijë lekë, në 2016-ën 8 milionë e 117 mijë lekë, në 2017-ën 11 milionë e 74 mijë lekë, në 2018-ën, deri në këtë periudhë, 6 milionë e 799 mijë lekë. Tatimi i mbajtur në burim, i detajuar.

Këtu ka një problematikë serioze me klubet. Po ju nxjerr tre klube të rëndësishme të vendit, të cilat i kanë dhënë dinjitet futbollit dhe që kanë nevojë për formalizim të mtejshëm. Ekipi i Skënderbeut, një klub dinjitoz, që i ka dhënë emër futbollit shqiptar gjatë këtyre viteve të vështira. Çfarë ndodh? Kristi Vangjeli, që e njihni shumë mirë, a e dini sa paguhet? 100 mijë lekë të rinj në muaj, ndërsa ekonomistja e klubit merr pak më shumë se Kristi Vangjeli, 130 mijë lekë të rinj në muaj. E dini sa kanë marrë këta futbollistë në 2014-ën? Ja ku e keni!

Duket sikur me këto listëpagesa këta futbollistë nuk kanë pasur mundësi të ushqeheshin për të qëndruar në këmbë, e le pastaj të luanin futboll. 22 mijë lekë futbollistët! Ja ku i keni, me emra! De Souza Martins paska

marrë 22 mijë lekë të rinj në muaj dhe, kur hyn në fushë, besoj se e mendoni që një njeri me 22 mijë lekë të rinj në muaj, nuk ka fuqi të japë spektakël.

E vërteta është se këtu ka nevojë për formalizim, për t'iu referuar pastaj jo Mesit, jo atij tjetrit.

Pastaj kemi "Tiranën". "Tirana" ndahet në dy periudha; periudha e "Tiranës" së kryetarit zyrtar të opozitës, dhe "Tirana" e kësaj periudhës që po flasim. A t'ju sjell një emër? Bujar Lubani, trajneri i madh e i nderuar merrte 36 mijë lekë në muaj.

Pastaj kemi Gugash Maganin, trajner futbollit. Ky punonte me zero. Ky s'merrte lekë. Ky s'merrte pagë. Ky e bënte nga pasioni për futbollin.

Pastaj kemi Klodian Dervishin, trajner futbollit. Edhe ky me zero.

Pastaj kemi Joze Maria, trajner futbollit, i cili merr vetëm 90 mijë lekë.

Pastaj kemi Ilion Likën, futbollist i madh: 90 mijë lekë.

Pastaj kemi Rafael Kostën, trajner futbollit: 60 mijë lekë.

Domethënë, e kuptoni sa larg janë klubet e futbollit nga formalizimi? Janë shumë larg.

Pastaj kemi Astrit Nallbanin. Paga bruto është 1 lek.

Nuk ekzagjeroj. I kam marrë nga tatimet. Ja ku i keni! 1 lek.

Pastaj kemi listëpagesat e klubit "Vllaznia": Armando Cungu, trajner futbollit: 544 mijë lekë.

Për hir të së vërtetës, klubi "Vllaznia" është më afër formalizimit. Ja ku e kemi!

Klubi "Partizani". Kemi dos Santos Alves, futbollist. Ky merr pagë bruto 130 mijë lekë në muaj.

Nuk flitet me të vjetra, zoti kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste!

Alban Hoxha: 100 mijë lekë të rinj. Futbollistë që, për hir të së vërtetës, kanë një refleksion më të përafërt me realitetin.

Çfarë dua të them me këtë? Formalizimi në klubet e futbollit është emergjencë. Federata Shqiptare e Futbollit, po ta krahasosh me vitin 2014, kur futbollistët merrnin një pagë minimale prej 22 mijë lekësh, në vitet e fundit, praktikisht, kanë filluar të reflektojnë paga më afër reales.

Jemi ende larg, sigurisht, por ka një avancë në drejtimin e duhur.

Unë jam i bindur se me ligjin e sportit, këtë të riun, që po kalojmë për vendimmarrje e pastaj për miratim në qeveri e në parlament, situata do të avancojë akoma më pozitivisht. Dua të them se është e dukshme që sporti ka shumë më shumë nevojë për t'u mbështetur nga qeveria, që futbollit ka shumë më shumë nevojë të formalizohet. E jo vetëm futbollit, por të gjitha sportet. Besoj se formalizimi është një instrument, që shërben për t'u kthyer dinjitetin atyre lojtarëve, të cilët, ju e mbani mend, i trajtuam si heronj në Kampionatin Europian. Në fakt, heronj janë me të vërtetë, sepse me punën e vet secili ia shton dinjitetin vendit. Ajo që ata bëjnë në fushë, që ne e ndjejmë si emocion në stolat e stadiumit, ata e kanë sfidë në fushën e gjelbër, dhe në natyrën e vet është një lloj heroizmi, që ka nevojë të mbështetet më tej me formalizim dhe me dinjitet.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Braçe, keni të drejtë deri në pesëmbëdhjetë minuta, që të shpreheni lidhur me përgjigjet e ministrit!

Erion Braçe – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Që në krye të herës, dua të them dy gjëra. Së pari, në asnjë rast nuk ka ndodhur që, qoftë në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Ekonomisë, qoftë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të mos kem vlerësuar përpjekjen e qeverisë së Kryeministrit Rama në luftë kundër evazionit fiskal dhe rritjen domethënëse të nivelit të të ardhurave të arkëtuara në buxhetin e shtetit. Por në asnjë rast nuk do ta mbyll gojën para individëve dhe institucioneve, që kanë fituar imunitet fiskal, qofshin ata “nderi i kombit”, qofshin llumi i kombit, sepse përpara ligjit janë të gjithë të barabartë. Përpara ligjit fiskal kanë detyrimin të paguajnë tatime dhe taksa.

Thënë këtë, unë nuk pyeta se sa paguhen klubet e futbollit, ekipet e futbollit apo lojtarët që luajnë me top në këtë vend. Unë pyeta: prej muajit shkurt, në mënyrën më të qartë të mundshme, sa është tatimi mbi të ardhurat personale, që paguhet nga institucioni Federata Shqiptare e Futbollit?

Së dyti: sa është 10-përqindëshi që i takon buxhetit të shtetit nga e drejta televizive që ka tregtuar Federata Shqiptare e Futbollit dhjetë vjetët e fundit?

Këto ishin dy pyetjet e mia, për të cilat nuk mora përgjigje. Ose, më saktë, për të parën mora një përgjigje, që është e pjesshme, dhe që sjell në vëmendje apo më jep të drejtë në lidhje me arsyen se përse e kam thirrur këtë interpelancë.

Po vijoj ta shpjegoj. Që në muajin shkurt, nën përgjegjësinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të detyrës sime si kryetar i Komisionit të Ekonomisë e të Financave të Kuvendit, nisur nga interesi publik, i lidhur fort me zbatimin e ligjit, të ligjeve fiskale dhe arkëtimin nga kushtet e detyrimeve tatimore, i kam kërkuar Ministrisë së Financave informacion lidhur me tatimin në burim për të ardhurat nga pagat, shpërblimet, honorarët dhe bonuset, që paguhen nga Federata Shqiptare e Futbollit për çdo të punësuar apo të kontraktuar gjatë tetë vjetëve të fundit.

Natyrisht, pas konsumimit të përgjigjeve që sapo dëgjova, përgjigje nuk kam marrë ende. Kërkesa ime është gërmë për gërmë kushtetuese dhe ligjore, pjesë e një praktike shumëvjeçare, që bart kërkesa të këtij lloji, me përgjigje të qarta, shoqëruar me informacionin e kërkuar, dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në ushtrim të detyrës dhe në respektim të ligjeve fiskale posaçërisht.

Çfarë ka ndodhur këtë herë që për tetë muaj me radhë nuk jepet përgjigje, e as këtu nuk jepet përgjigje? Ligji nr. 8438, datët 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, në nenin 8, “E ardhura e tatueshme” sanksionon: “Për qëllime tatimi mbi të ardhura personale merren si të ardhura të tatueshme pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës. Të ardhurat e tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”...

Udhëzimi nr 5 i datës 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, në kapitullin 2, “Tatimi mbi të ardhurat personale”, pika 2 dhe 3, në zbatim të nenit 8, të ardhura të tatueshme detajon: “Të ardhura të tatueshme për qëllime mbi të ardhurat personale, janë kategoritë e të ardhurave të mëposhtme: “2, 3, 1 pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me

marrëdhëniet aktuale të punës, të ardhura nga punësimi”. Në këtë kategori të ardhurash përfshihen si pagat, ashtu edhe shpërblimet e tjera në vlerë, që lidhen me punësimin aktual të individit. Në të ardhurat nga pagat përfshihen paga bazë, si dhe të gjitha shtesat mbi pagën bazë, që kanë karakter të përhershëm si shtesa për vjetërsi pune, vështirësi, largësi vendbanimi, natyrë të veçantë pune apo shërbimi, si dhe shtesa të tjera page e shpërblimi, të bëra me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Termi “shpërblime të tjera” përfshin të gjitha të ardhurat apo shpërblimet, që përfitohen nga rezultatet e punës në vendin e punësimit aktual të individit. Në këtë kategori bëjnë pjesë të ardhurat që individit merr në formë shpërblimi nga fondi i veçantë apo nga fonde të krijuara me akte të ndryshme ligjore apo statusore, nga shoqëri ose shoqata e kështu me radhë.

Në grupin “shpërblime të tjera” përfshihen gjithashtu të ardhurat që realizohen nga pjesëmarrja e individit në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse e të tjera.

Natyrisht, në referencë të këtyre përcaktimeve në ligj e në udhëzim, unë kam kërkuar sqarime se sa është niveli i këtyre tatimeve që ka paguar Federata Shqiptare e Futbollit, bashkë me individët që ka brenda saj.

Ligji nr. 9920, datë 19. 05. 2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, në kreun 10: “Kontrolli tatimor”, neni 80, sanksionon: “Administrata tatimore kontrollon deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet aktive e pasive dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta. Kontrolli i tatimpaguesit bazohet në deklaratat e dhëna nga tatimpaguesi, si dhe nga librat, regjistrimet dhe informacionin e dhënë nga palët e treta ose në përputhje me mënyrat alternative të vlerësimit, parashikuar në nenin 72 të këtij ligji. Administrata tatimore kontrollon saktësinë e të gjitha dokumenteve, që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore, si edhe çdo dokument tjetër me rëndësi për caktimin e detyrimit tatimor. Kontrolli tatimor është një detyrim ligjor për administratën tatimore, pjesë e detyrës së përditshme ligjore

të saj dhe pjesë e këtij kontrolli janë (po citoj pikën 3): “Pagesat dhe detyrimet tatimore si edhe çdo dokument tjetër me rëndësi për caktimin e detyrimit tatimor”. Neni 127 dhe këtu po e mbyll: “Pengimi i kontrollit ose hetimit tatimor sanksionon: në rast se organet tatimore kanë të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike dhe financiare, organet tatimore kanë të drejtë t’ia sekuestrojnë dokumentacionin, pajisjet kompjuterike dhe fiskale dhe mjete të tjera të mbajtjes së dokumentacionit të tatimpaguesit në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë së tij”. Pra, ligjvënësi, ju deputetët e Kuvendit të Shqipërisë u keni dhënë të gjitha atributet ministrit dhe organeve fiskale që të bëjnë detyrën në raport edhe me Federatën Shqiptare të Futbollit.

E dëgjova ministrin pak më parë që iu referua të dhënave të personelit, të pagave të paguara nga Federata Shqiptare e Futbollit dhe nuk kisha pikë dyshimi se do të ishte ajo shifër. Pse?

Zoti Ministër, ky është një dokument zyrtar i FSHF-së, i depozituar në Asamblenë e Përgjithshme të vitit 2017. Këtu ka dy zëra për pagat: një zë është për personel jashtë federatës dhe vlera për vitin 2015 ka qenë 212,3 milionë lekë, në vitin 2016 ka qenë 246,124 milionë lekë dhe zëri tjetër janë shpenzimet e personelit, që iu referuat edhe ju 84,2 milionë lekë në vitin 2015 dhe 96,5 më 31 dhjetor të vitit 2016. Pa diskutim që unë kam edhe të dhënat e vitit 2017, i cili ka 91,1 milionë për personelin e FSHF-së dhe për pagat jashtë federatës të paguara nga federata janë 230,1 milionë lekë të tjera. A mund të më thoni se çfarë është ky zë, meqenëse morët përsipër të lexonit bilancin e Federatës Shqiptare të Futbollit? Çfarë është zëri: “Paga jashtë federatës?”. Sa tatim është paguar për pagat jashtë federatës? Vlera është pothuajse tre herë më e madhe sesa vlera e pagave të paguara për personelin e federatës, atë të brendshmin, në vitin 2015 shkon 212,3 milionë, 246,1 milionë në vitin 2016 dhe 230,1 milionë në vitin 2017. Për vitin 2018 nuk e kam. Ju kërkoj ndjesë që nuk jam i përditësuar edhe për këtë vit! Thelbi i pyetjes sime kishte të bënte me këto para. Përtej këtyre parave ka edhe një zë tjetër, në këtë dokument të FSHF-së, certifikuar edhe nga kompania që auditon këtë të fundit është zëri: “Shpërblime për arritjet

sportive”. Është e vërtetë që në vitin 2014 ka qenë 204 milionë lekë, në vitin 2016, vitin e sukseseve të mëdha, zoti Ministër, të cilit iu referuat edhe ju nuk ka qenë 1 milion dollarë, më vjen keq, por 637 milionë lekë ose 6,3 milionë dollarë. Pyetja që kam unë: sa është tatimi në burim për këto para, apo “heronjve të kombit” nuk u mbahet tatim në burim? Për vitin 2017 është 136 milionë lekë të tjera për arritjet sportive. Më thënë të drejtën në vitin 2017 unë nuk di ndonjë arritje sportive, përveçse një sërë akuzash që rëndojnë, sot e gjithë ditën mbi futbollin shqiptar. Pra, thënë të gjitha këto, shqetësimi im është për këto para dhe tatimin e këtyre parave të FSHF-së.

Pyetja e dytë ka të bëjë me të drejtën televizive, një element tjetër shumë i rëndësishëm për të cilin FSHF-ja arkëton para, ndan një pjesë të tyre dhe pastaj mban para, për të cilën buxheti i shtetit duhet të arkëtojë 10% të vlerës së të drejtës televizive.

I doni numrat?

Urdhëroni! Sipas këtij dokumenti të FSHF-së për vitin 2015 shitja e të drejtës televizive kombëtare brenda vendit është 49,3 milionë lekë, për vitin 2016 është 56,1 milionë lekë, për vitin 2017 është 49,1 milionë lekë. Shitja e së drejtës televizive për Kombëtaren e Futbollit në vitin 2015 është 367,4 milionë lekë, për vitin 2016 është 347, 2 milionë lekë, në vitin 2017 është 340 milionë lekë. Pyetja ime është: e keni arkëtuar 10 %-shin apo jo?

Pa diskutim që nuk janë të ardhura tatimore, por unë nuk e pranoj dot talljen, që është konsumuar gjatë gjithë këtyre muajve, kur unë ju kam pyetur për këtë gjë. Në fillim i drejtoni një letër RTSH-së, e cila nuk zotëron të drejtat televizive, blen të drejtat televizive. Zotëruesi i të drejtës televizive në kuptimin e ligjit “Për sportin” është FSHF-ja. I drejtoheni një institucioni që nuk ka lidhje me këtë pjesë. Në fund fare i drejtoheni Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për të arkëtuar këtë vlerë. Pyetja ime është: për 10 vjet ku ka shkuar 10%-shi që ju duhet të arkëtoni?

E di fare mirë, ju kam mbështetur ju, kam mbështetur Kryeministrin Rama për t’i dhënë para FSHF-së për të ndërtuar impiante sportive, që nuk i ka pasur kurrë ky vend. Kjo është meritë e kësaj qeverie, por detyrimet ligjore janë detyrime ligjore. Unë besoj se buxheti i shtetit

nuk ka nevojë për 300 mijë dollarët që arkëtohen nga këto vlera, pa asnjë lloj diskutimi, por ky është detyrim ligjor. Nga anë tjetër e kuptoj fare mirë që përsëri nuk kemi nevojë për 300 mijë dollarë të FSHF-së, por ligjshmëria fiskale e FSHF-së është një element domethënës kyç, nëse ne duam një futboll të drejtë dhe të ndershem në këtë vend. Nuk mundet që të ketë imunitet FSHF-ja nga detyrimet tatimore! A i dëgjua lajmet dje? A e patë se çfarë ndodhi në zemër të Europës? Janë mbi 100 vetë të arrestuar në Belgjikë, trajnerë, zyrtarë federatash, arbitra futbollit, menaxherë klubesh, lojtarë, të gjithë të përfshirë në një xhiro marramendëse kriminale me paratë. Atëherë, për çfarë flasim? Kur kjo ndodh në mes dhe në zemër edhe të Europës, pse duhet të pranojmë alibinë e një njeriu që nuk heq dorë nga një karrige atje, pikërisht për shkak të këtyre përfitimeve që administrohen vit për vit në FSHF, përfitime të paligjshme në raport me ligjet fiskale të këtij vendi? Pse i dashka dhënë imunitet fiskal një institucioni të tillë? Më lejoni t’ju them: “Po, bëni detyrën. Shkoni dhe trokisni në çdo dyqan të këtij vendi. Trokisni në çdo kafene dhe në çdo qebaptore të këtij vendi për të mbledhur taksat! Mirë bëni! Ka edhe abuzime në këtë që bëni, por të mëdhenjtë kur do të paguajnë? Këta që administrojnë miliona lekë, këta që dalin mburren dhe kapardisen nga mëngjesi deri në darkë në televizione, por edhe rrugëve të këtij qyteti duhet të jenë këta të parët që duhet të japin shembull.

Nuk ta solla Ronaldon, për ta krahasuar me Kristi Vangjelin, ta solla Ronaldon si shembull të administratës fiskale spanjolle për të bërë drejtësi fiskale me cilindo, nga më i pushtetshmi dhe deri tek ai që ka një dyqan akulloresh në qendër të Madridit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zoti Braçe!

(Ndërhyrje nga salla)

Zoti Fino, qetësi!

Zoti Ministër, keni 3 minuta kohë për t’u shprehur.

Arben Ahmetaj - Zoti Ruçi, mendoj që të harxhosh kaq shumë kohë për Federatën Shqiptare të Futbollit dhe për sportin është gjëja e duhur, madje më shumë duhet të harxhojmë, ia vlen që të fokusohemi dhe të bastet. Para se të flas për bastet sportive, do t’i rikthehem, në

respekt të së vërtetës së ligjit, Federatës Shqiptare të Futbollit, e cila ka statusin e organizatës jofitimprurëse. Federata Shqiptare e Futbollit deklaroi në organin tatimor tatimin mbi të ardhurat personale, kontributet e sigurimeve, TVSH-në për veprimtarinë e shitjeve që ushtron, tatime të tjera që i mban në burim në bazë të ligjit.

Po i rilexoj, përpara se të flas për bastet, edhe një herë. Federata Shqiptare e Futbollit ka në listëpagesa: 57 të punësuar në vitin 2014, 55 të punësuar në vitin 2015, 62 të punësuar në vitin 2016, 72 të punësuar në vitin 2017 dhe 72 të punësuar në vitin 2018. Gjatë viteve 2014-2018, pra për periudhën që jemi duke folur e deri në fund të gushtit, ka paguar 75 milionë lekë kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore, që do të thotë, për qytetarët, nga listëpagesa, jo ata që ofrojnë shërbime teknike, pra në të vërtetën e ligjit, por ata që janë të punësuar. Tatim mbi të ardhurat nga punësimi ka paguar 38 milionë e 501 mijë lekë, tatim i mbajtur në burim për pagesa 170 milionë e 279 mijë lekë, totali i pagesave për vitin 2014-2018 në buxhet është 283 milionë e 853 mijë lekë, pagesa për shërbime teknike, shërbimet e manaxhimit, shërbime financiare dhe ato të sigurimit janë 95 milionë lekë, e ardhura tatim i mbajtur në burim 9,6 milionë lekë, pagesat për menaxhim dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues, e ardhura është 35 milionë lekë, tatim i mbajtur në burim 5,36 milionë lekë, pagesat për qiratë, e ardhura është 11 milionë lekë, tatim i mbajtur në burim 2,1 milionë lekë, pagesat për shfaqjet e aktorëve, muzikantëve apo sportistëve, e ardhura është 964 milionë lekë...

Gramoz Ruçi- Faleminderit, zoti Ministër!
(Ndërhyrje nga salla)

Zoti Ministër, tani është i mbyllur.

Zoti Braçe, nëse dëshironi, keni 3 minuta kohë.

(Ndërhyrje nga salla)

Duhet të mësoheni të zbatoni Rregulloren të gjithë pa përjashtim.

Erion Braçe - Zoti Ministër, pa më futur në një diskutim, unë do ta harxhoj kohën edhe për këtë gjë. E kuptoj ironinë tuaj, ishte shumë e zgjuar, por problemi është se do të vazhdoj ta harxhoj kohën për këtë. E di pse? Është shumë e thjeshtë; dje në orën 15:20 të drekës, zyrtarët e hetimit tatimor të Fierit kanë shkuar në një lokal

në fshatin Çermë në 15:20. E kanë gjetur lokalin bosh dhe e kanë gjobitur me 500 mijë lekë për mosprerje të kuponit tatimor. Në lokalin bosh, mosprerje të kuponit tatimor! Ndërkohë, unë i kërkova pronarit të lokalit t'i binte kasës në momentin kur ata ishin atje. Pronari i ra kasës dhe urdhëroni se çfarë del nga kasa: në orën 15:28, kuponi nr. 130. Por kur kjo ndodh me një fakir, në mes të Çermës, pse nuk u dashka të ndodhë me një (çfarë t'i them unë atij) në krye të Federatës Shqiptare të Futbollit?! Pse? Cila është arsyeja? Prandaj do ta harxhoj kohën këtu. Do ta harxhoj kohën për këta fakirët, zoti Ministër, pa asnjë lloj diskutimi!

Jua thashë, e çmoj shumë gjithçka keni bërë në këta 5 vjet në qeveri, për të arkëtuar në maksimum të ardhurat, që përcaktohen në ligjet respektive dhe detyrimet që përcakton buxheti i shtetit, por, në krahun tjetër, do të refuzoj që çdo fakir i këtij vendi të jetë objekt i ligjeve fiskale dhe këta të tjerët, si puna e këtij, që është në krye të Federatës Shqiptare të Futbollit, të kenë imunitet fiskal, me persona apo personel jashtë Federatës Shqiptare të Futbollit, jashtë detyrimeve për të paguar të drejtën televizive! Ky është shqetësimi im.

Për pjesën tjetër, pa asnjë lloj diskutimi, zoti Ministër, kam më shumë se një vit që flas për baste këtu në sallën e Kuvendit.

Dua ta duartrokas qeverinë dhe Kryeministrin Rama për vendimin që kanë marrë për të larguar bastet nga qendrat e banuara, për t'i mbyllur fare ato.

Pa as më të voglin diskutim, ashtu siç kam ngritur këtu në këtë sallë shqetësimin, që ligji aktual "Për lojërat e fatit", në disa segmente të tij, nuk është zbatuar, patjetër që keni një duartrokitje për lojërat elektronike të fatit, të cilat kanë hyrë pothuajse në 90% e kusur në fiskalizim. Për bastet, më lejoni t'ju them që në 80% të xhiros së tyre janë jashtë fiskalitetit.

Po jua përsëris edhe një herë tani: shtetëzoheni aktivitetin e lojërave të fatit! Shtetëzoheni, kthejeni në monopol shtetëror dhe, ju lutem shumë, bëjeni këtë gjë, që të mos kthehet pastaj në një guerrilje mes jush dhe kompanive të basteve nëpër bodrume...!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Braçe!

(Deputeti Erion Braçe flet pa mikrofon)

(Duartrokitje në sallë)

Faleminderit!

Këtu mbyllet interpelanca e kërkuar nga zoti Braçe me ministrin Ahmetaj.

Do të inkurajoja dhe do t'u kërkoja të gjithëve kolegëve deputetë që, edhe në të ardhmen, instrumentet parlamentare, siç janë seancat e pyetjeve, të interpelancave dhe të mocioneve me debat, të jenë më të vijueshme dhe më permanente në parlament, për të ushtruar kontrollin parlamentar.

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar.””

Sot do të shqyrtojmë dy nisma të depozituara në Kuvend, njëra nga Këshilli i Ministrave dhe tjetra nga një grup deputetësh. Komisioni përgjegjës i ka shqyrtuar të dyja nismat së bashku dhe ka caktuar një relator. Njëkohësisht, në seancë do t'i shqyrtojmë të dyja nismat së bashku.

Doja të tërhiqja vëmendjen e kolegëve deputetë, por edhe të publikut shqiptar, nëpërmjet medias, që këto janë dy nisma shumë të rëndësishme dhe zgjidhin dy probleme mjaft të mëdha, pasi në Shqipëri ekzistojnë mbi 10 mijë fëmijë të paregjistruar, njëkohësisht ekzistojnë edhe mbi 8 mijë të vdekur të paregjistruar. Pra, të dyja nismat kanë të bëjnë me zgjidhjen e këtyre dy problemeve, këtu e tri dekada më parë.

Prandaj, në këtë kuadër, dua të përgëzoj nismën e Këshillit të Ministrave dhe veçanërisht atë të grupit të deputetëve.

Pa humbur kohë, fjalën ia kaloj zonjës Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Qytetari, të drejtat e fëmijëve dhe shërbimet ndaj tyre, janë në vëmendje të kësaj maxhorance.

Në nëntor të vitit 2013 Kuvendi i Shqipërisë miratoi një rezolutë për të drejtat e fëmijëve dhe premtoi një angazhim më të madh të parlamentarëve në mbrojtjen e fëmijëve dhe, në vitin 2014, një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë krijuan grupin e deputetëve “Miqte e fëmijëve”, grupim jopartiak...

Gramoz Ruçi - Elektronika të nxjerrë kohën!

Vasilika Hysi - ...i fokusuar për të lobuar për mbrojtjen më të mirë të të drejtave të fëmijëve.

Të mos harrojmë se në vitin 2017 Kuvendi i Shqipërisë miratoi rezolutën për promovimin

dhe monitorimin e përmbushjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, mes të cilave është edhe fëmija dhe mirëqenia e tij. Pra, kemi ndërmarrë një sërë angazhimesh për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe për të forcuar kontrollin parlamentar për respektimin e të drejtave të fëmijëve. Kemi ndërmarrë një sërë angazhimesh për të kontrolluar më mirë qeverinë, për një mbrojtje më të mirë të të drejtave të fëmijëve, pa diskriminim.

Sot, para se të përgatisja këtë fjalë, bëra një bilanc se çfarë ka bërë Kuvendi i Shqipërisë, kjo maxhorancë, që nga momenti i miratimit të rezolutës për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Nga 10 masa, 8 prej tyre janë zbatuar, por ka ende shumë për të bërë.

Një ndër rekomandimet dhe angazhimet tona ka qenë regjistrimi i fëmijëve, problem, sikurse me të drejtë e tha edhe Kryetari i Kuvendit, njëkohësisht edhe Kryetari i grupit të deputetëve “Miqte e fëmijëve”, i pazgjidhur për 25 vjet.

Të mos harrojmë, të nderuar kolegë, se Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Gjenevë, në tetor të 2012-s i ka paraqitur qeverisë shqiptare një sërë rekomandimesh për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve.

Sot ndihem e privilegjuar që jam pjesë e kësaj maxhorancë dhe që qeveria “Rama 1” dhe “Rama 2” po përmbush pjesën më të madhe të këtyre rekomandimeve.

Kështu, krahas miratimit të ligjit “Për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre” dhe falë reformës në drejtësi, përmbushëm pjesën më të madhe të rekomandimeve, por parandalimi i dhunës ndaj fëmijëve është një sfidë, për të cilën kemi ende shumë për të bërë.

Ky angazhim fillon pikërisht me modelin e të sjellurit tonë në sallë dhe në publik, në tubime dhe në debate parlamentare, por, mbi të gjitha, në ushtrimin e funksioneve tona.

Të dyja nismat që po diskutojmë sot, projektligji i propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe ai i propozuar nga 19 deputetë (kam bindjen se të gjithë deputetët do ta firmosnin), adresojnë 3 probleme madhore dhe këtu do t'u drejtohesha, në radhë të parë, të gjithë qytetarëve.

Së pari, mundësojnë rregullimin e situatës së fëmijëve të lindur jashtë vendit, veçanërisht të fëmijëve me prindër që jetonin jashtë vendit, që janë rikthyer në Shqipëri dhe nuk kanë mundësi

të rikthehen, për shkak se kanë qenë emigrantë të parregullt.

Së dyti, zgjidhin problemin e çregjistrimit të personave, të cilët kanë vdekur prej vitesh dhe nuk kanë mundur të bëjnë procedurën familjare, për shkak të gjobave ose për shkak se jetojnë jashtë.

Së treti, u mundësojnë shtetasve tanë lehtësimin për të kryer procedurën e regjistrimit në vendbanimin e tyre. Në këtë mënyrë, shteti ka një inventar të saktë të shtetasve, se ku banojnë ata, por edhe adreson më mirë buxhetin në nivel vendor.

Këto nisma përmbushin një sërë rekomandimesh të institucioneve ndërkombëtare, por sot Kuvendi me nismën e deputetëve përmbush rekomandimin e Komunitetit të Mbrojtjes së Fëmijëve, i cili i sugjeron qeverisë shqiptare të sigurohet regjistrimi i lindjes pa pagesë, duke punuar në mënyrë proaktive për fëmijët me rrezik të madh, të regjistroheshin të gjithë fëmijët në shkollë, pavarësisht nga regjistrimi në Gjendjen Civile, si dhe të zbatohen sanksione administrative për mosregjistrimin e tyre.

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Pa dashur të përsëris atë që tha Kryetari i Kuvendit dhe Kryetari i grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve”, sot, me këtë projektligj që do të miratojmë, do të zgjidhim një problem 25-vjeçar. Pra, sot, qytetarëve shqiptarë, me fëmijë të lindur jashtë vendit, që nuk kanë mundësi të plotësojnë defektet që mund të kenë certifikatat e lindjes dhe që nuk e kanë marrë dot në formën e përcaktuar nga ligji, së fundi u garantohej kjo e drejtë, por, nga ana tjetër, edhe një sërë kërkesash burokratike dhe procedura, që administrata publike i ka të rregulluara ose të përcaktuara në ligj ose janë të parashikuara në aktet nënligjore, që shpesh dalin edhe mbi ligjin dhe ia bëjnë qytetarit më të vështirë jetën, marrin fund.

Prandaj, në këtë kuadër, unë do t’ju kërkoj të gjithëve, të nderuar kolegë dhe kolege, që këtë ligj t’ua bëjmë të ditur të gjithë qytetarëve në zonat ku jemi të zgjedhur, por, nga ana tjetër, do t’u kërkoja ministrive përgjegjëse të zbatimit të ligjit, të fillonin jo vetëm një fushatë informimi dhe sensibilizimi, por edhe të jenë proaktive për të zbatuar ligjin.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, kjo nismë, e cila u prezantua si një shqetësim nga UNICEF-i dhe nga UNHCR-ja, si dhe nga ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë të shoqërisë civile, nuk do të ishte e mundur të ndërmerrej në një kohë të shkurtër, në më pak se tre muaj, pa angazhimin e grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve” dhe rekomandimin e detyrën konkrete të lënë nga Kryetari i këtij grupi.

Ndaj, më lejoni t’ju falënderoj të gjithëve ju, por edhe të gjithë deputetët që nuk janë pjesë e grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve”, që në dy takimet e organizuara nga Kryetari i Kuvendit morët pjesë në mënyrë aktive, diskutuat dhe ndatë këto shqetësime!

Në emrin tuaj, besoj se një meritë e veçantë dhe një falënderim i shkon Klinikës Ligjore Falas në Tiranë, ekspertëve, të cilët morën angazhimin të hartonin një projektligj, ashtu sikurse u la detyrë edhe nga Kryetari i Kuvendit, dhe ta paraqisnin atë para grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve”!

Nga ana tjetër, të nderuar kolegë, do të doja që nga kjo foltore e Kuvendit, t’u drejtohesha në mënyrë të veçantë të gjithë ministrave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.

Në radhë të parë, ftoj ministrin e Brendshëm, që së bashku me ministrin për Shëndetësinë dhe Çështjet Sociale, të hartojnë brenda tre muajve aktet nënligjore. Është përvojë jo e mirë në disa raste (ligjet që miraton Kuvendi janë shumë të mira), që aktet nënligjore dalin me vonesë ose ia vështirësojnë më shumë jetën qytetarit në marrjen e shërbimeve publike. Pra, e ritheksoj edhe një herë: akte nënligjore që të mbajnë parasysh interesin më të lartë të fëmijës, që të lehtësojnë burokracinë dhe të jenë në përputhje me atë shqetësim që Kryeministri Rama e ka ngritur disa herë, për të bërë reformën e deregullimit, që atë reformë ta çojmë kudo, në çdo skaj të Shqipërisë, në çdo zyrë të administratës publike, te çdo person që i shërben qytetarit, pavarësisht bindjeve politike.

Së dyti, ftoj ministrin e Brendshëm të shikojë, së bashku me ministrin e Financave, projektbuxhetin e vitit 2019, për të mbuluar kostot e analizës së ADN-së dhe të gjitha kostot për sigurimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Kemi miratuar ligjin “Për ndihmën juridike” të garantuar nga shteti, kemi miratuar ligjin “Për taksat gjyqësore”, si dhe kemi

mundësuar përjashtimin e një sërë kategorive, ku hyjnë edhe këta fëmijë, të cilët vijnë nga familje pa mundësi ekonomike, por sot kërkohet një buxhetim, jo thjesht gjinor, por që duhet të mbajë parasysh interesin më të lartë të fëmijëve.

Besoj se do të jemi këtu në muajin nëntor, për të bërë seanca dëgjimore dhe për të ushtruar kontrollin parlamentar, për të pasur një buxhetim që do të mundësojë zbatimin e këtij ligji, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe jetik për mijëra familje.

Së treti, ftoj ministren e Drejtësisë (besoj se shumë shpejt do të kemi një seancë dëgjimore për drejtësinë e të miturve dhe zbatimin e strategjisë për drejtësinë e të miturve, pasi ky ligj nuk mund të zbatohet dhe qytetari nuk mund të vlerësojë efektet e tij nëse ne nuk monitorojmë shërbimet ligjore të atashuara pranë sistemit gjyqësor) që, së bashku me Shkollën e Magjistraturës dhe Ministrinë e Brendshme, të hartojnë një plan trajnimesh të përbashkëta të magistratëve, pra të gjyqtarëve kudo që ofrojnë shërbim, si dhe të përgjegjësve të zyrave të gjendjes civile, me qëllim që ta kuptojnë dhe ta zbatojnë këtë ligj në mënyrë të njëjtë.

Sot, ata deputetë që kanë përvojë dhe vijnë nga gjyqësori, e dinë shumë mirë që ligjet, ndryshe i lexon administrata e zyrave të gjendjes civile, ndryshe i lexojnë gjyqtarët, ndryshe i lexojnë zyrat e Tiranës dhe ndryshe i lexojnë zyrat e Durrësit, Fierit, Shkodrës e të tjerë. Pra, ka nevojë për një unifikim, kuptim, përgjegjshmëri, si dhe një kontroll të praktikave të zbatimit të këtij ligji.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, e ftoj ministrin e Financave që këtë paketë ligjesh, të cilën po e miratojmë sot, ta buxhetojmë komform ligjeve. Mund të duket që buxheti nuk ka para mjaftueshëm, sepse jemi një vend i varfër, por nëse zgjidhim këto probleme, ne do të kursejmë më shumë buxhet sesa kemi shpenzuar deri sot.

Të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë këtë projektligj dhe të forcojmë kontrollin parlamentar për zbatimin e tij.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Hysi!

Flakë për flakë, sapo e ftove ministrin e Financave të përgjigjet.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Kryetar!

E mora fjalën meqenëse deputetja Hysi iu referua Ministrisë së Financave për sa i përket

mbështetjes së parlamentit për iniciativat e qeverisë për gjendjen civile.

Besoj se sot duhet të flisnim të gjithë për iniciativën e Kryeministrit dhe qeverisë për kthimin e ligjshmërisë së plotë në fushën e basteve sportive. Është marrë një vendim nga Kryeministri, i materializuar në një draftligj, i cili shumë shpejt do të vijë në parlament, për mbylljen e basteve sportive dhe basteve të garave. Kjo nismë erdhi si referencë e thirrjes së qytetarëve në mbarë Shqipërinë për të mbyllur një industri, e cila, fatkeqësisht, u kthye në një plagë sociale.

Është e rëndësishme të dimë se nga kemi ardhur dhe ku shkojmë. Deri në vitin 2013, nga 40 kompani bastesh të ardhurat e buxhetit të shtetit ishin 3,7 miliardë, ndërsa sot nga 20 kompani të ardhurat e buxhetit të shtetit janë 5,4 miliardë. Me gjithë formalizimin e vazhdueshëm, zgjodhëm një mënyrë drastike për ta mbyllur këtë industri, e cila, me të gjithë përpjekjet e vazhdueshme, rezultoi e vështirë për t'u kontrolluar në të gjitha aspektet.

Thelbi i propozimit të Kryeministrit, i materializuar në një draftligj, është: më 1 janar do të mbyllet të gjitha pikat e basteve në Republikën e Shqipërisë. Nuk do të ketë më pika bastesh dhe nuk do të ketë më kazino elektronike. Çështja e kazinove elektronike në qendrat e banuara është vendosur që në vitin 2015, është shtyrë disa herë me iniciativa deputetësh, por ka ardhur dita që 1 janari i vitit 2019 të bëjë një diferencë, Republika e Shqipërisë nuk do të ketë më pika bastesh dhe nuk do të ketë më kazino elektronike.

Dje dikush më pyeti: “Çfarë do të ndodhë me të ardhurat që nuk do të mbledhë buxheti i shtetit nga këto kompani? Po me të punësuarit në këtë industri çfarë do të ndodhë?”. Patjetër që këto janë dy shqetësime reale dhe legjitime, por kur vëmë në balancë interesin e qytetarëve dhe kërkesat e tyre në vazhdimësi, në raport me dy elementet që përmenda, prevalon me një rëndësi të veçantë dhe me emergjencë kombëtare mbyllja e pikave të basteve dhe kazinove elektronike, që u kthyen në një plagë sociale. Kjo është arsyeja pse Kryeministri dhe qeveria kanë avancuar me atë propozim ligjor.

Së dyti, ne jemi duke përgatitur një program rikualifikimi për të gjithë ata që do të dalin të papunë nga kjo industri. Shërbimi

Kombëtar i Punësimit menjëherë, me materializimin e propozimit të Kryeministrit për mbylljen e pikave të basteve, ka filluar punën për hartimin e një programi specifik për rikualifikim të detyrueshëm.

Dua të informoj qytetarët se vitin tjetër ne fillojmë një fushatë të plotë rikualifikimi për të gjithë të papunët e regjistruar, por jo vetëm, të cilët kualifikohen me aftësi, që i ndihmojnë ata për të gjetur punë dhe për t'u paraqitur në intervistë në mënyrë dinjitoze. Janë 63 mijë të papunë, të regjistruar dhe të paregjistruar. Do të dyfishojmë numrin e të kualifikuarve, pra të trajnuarve në formimin profesional, me profesione duke filluar që nga grafik dizajn, meqenëse te bastet shumica e punës është me platforma kompjuterike. Të punësuarit te bastet, të cilët do të dalin të papunë, kanë mundësi të rikualifikohen më tej dhe të gjejnë vende pune në industrinë e tjera.

Kjo iniciativë e Kryeministrit për të mbyllur bastet besoj se është jo vetëm për t'u përshëndetur, por edhe për t'u mbështetur.

U bënë gati 25 vjet që flasim për bastet e për lojërat e fatit dhe besoj se është një moment i mirë, i duhur dhe vendimtar për ta ndarë historinë e kësaj industrie në dy epoka: epoka deri në fund të vitit 2018 dhe epoka e pastër më 1 janar 2019 e tutje.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Fjalën e ka Elisa Spiropali.

Elisa Spiropali – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji për ndryshimet në gjendjen civile vjen si një domosdoshmëri për ndryshimin e disa aspekteve në regjistrimin e fëmijëve në territorin e Republikës së Shqipërisë. E gjithë paketa e propozimeve që ne kemi, ligji i gjendjes civile, ai për sigurinë në shkollë dhe mbyllja e pikave të basteve, vjen si nevojë e materializimit të vullnetit tonë për regjistrimin e fëmijëve, por edhe për mbrojtjen e tyre nga kriminaliteti dhe nga retorika helmuese, për të cilën do të flas pak më vonë.

Me sa më rezulton nga shoqatat, me të cilat kemi bërë konsultime publike për këtë projektligj edhe në grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve”, i udhëhequr nga Kryetari Kuvendi, janë me

mijëra fëmijë që e kanë të pamundur për t'u regjistruar.

Në tryezat e organizuara së bashku, që kanë qenë shumë produktive dhe me një rezultat konkret tashmë, jemi informuar se vetëm gjatë vitit 2017 Klinika Ligjore Falas në Tiranë ka shqyrtuar plot 631 raste fëmijësh të paregjistruar, të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë apo të lindur këtu, të cilët për arsye më shpesh ekonomike, social-ekonomike apo kulturore, nuk janë regjistruar. Ky projektligj u jep zgjidhje problematikave duke ngritur edhe njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, e cila do të ketë detyrim ligjor për të regjistruar çdo fëmijë që lind në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht vullnetit apo kushteve të prindërve.

Propozimet e bëra në këtë projektligj ndjekin çështjet rast pas rasti edhe për fëmijët e lindur jashtë territorit, edhe për fëmijët e lindur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në këto tryeza, siç ishte “Miq të fëmijëve” në Kuvend, ulërin edhe një herë nevoja që kemi ne si parlamentarë dhe si deputetë t'i kthehemi diskutimit të çështjeve për njerëzit dhe me njerëzit.

Jo më kot nisma e qeverisë dhe e Kryeministrit, tashmë e materializuar në një projektligj, do të marrë masa për mbylljen e kazinove dhe basteve sportive në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky problem i vjetër dhe i thellë social, i cili ka shkaktuar jo pak dëm ekonomik në familjet shqiptare, sipas të gjitha raporteve tona, ka ndihmuar edhe në pastrimin e parave dhe krimin e organizuar.

Oficerët e sigurisë nëpër shkollë, gjithashtu, do të jenë për sigurinë e fëmijëve dhe do të operojnë jo si policë, por si një trupë e veshur në mënyrë civile, e cila do të jetë në ndihmë të fëmijëve.

Ndryshimet ligjore për sigurinë në burgje, po ashtu adresojnë në thelb çështjet e sigurisë, sepse kriminelët ende dhe shpesh drejtojnë grupet kriminale nga qelitë e burgjeve. Burgjet janë ndërtuar që kriminelët të vuajnë dënimin dhe jo të drejtojnë organizatat e tyre.

Dua të theksoj se mbyllja e pikave të basteve dhe kazinove është një nismë, sigurisht, e guximshme, por e domosdoshme për ta kthyer të gjithë këtë sektor në formalitet të plotë për t'i prerë krahët kriminalitetit, që shpesh financohet

nga bastet dhe kazinotë, një aktivitet i tërë informal dhe i paligjshëm.

Gjithashtu, kjo nismë u jep frymëmarrje lagjeve dhe qyteteve tona, ku pikat e basteve, fatkeqësisht, kanë mbjellë shumë dëshpërim.

Duke nisur nga dita e djeshme shohim edhe pasojat konkrete në zbatimin e plotë të ligjit për lojërat e fatit, ku portalet, gazetatat dhe televizionet kanë detyrim të heqin menjëherë reklamën për bastet dhe lojërat e fatit.

Ndryshimet për sigurinë në burgje, po ashtu janë në vazhden e operacionit të kësaj maxhorance për forcën e ligjit. Ne e godasim krimin me masa konkrete e me ligje dhe me të nuk bëjmë politikë.

Dua të kaloj te pika më e rëndësishme e këtij diskutimi, që është përdorimi, deformimi, manipulimi dhe inskenimi kriminal në tërësinë e vet, ku, fatkeqësisht, opozita ka zhytur përfaqësues të saj të rëndësishëm. Është e paimagjinueshme që një opozitë parlamentare, një parti që synon qeverisjen e vendit, të futet aq thellë në gjirizet e krimit për të nxjerrë prej andej fakte të manipuluar për të goditur qeverinë dhe maxhornacën e një vendi. Pushteti merret me votë dhe jo me telenovela. Fatkeqësisht, telenovelat orientale, të cilat janë shtuar nëpër televizionet tona kombëtare, kanë ndikuar aq rëndë në psiken e opozitës, sa që tani kemi skenarë të tërë me kriminelë dhe mafiozë nëpër dyer komisaratesh, me politikanë që kërcënojnë oficerë policie dhe me vajza të pambrojtura, të cilat keqpërdoren egërsisht nëpër deklarata publike, duke mbërritur deri te përdorimi i trupit të një vajze si armë politike për të goditur kundërshtarin. Tani, kur prokuroria dhe gjykata po i zbërthejnë këta skenarë, që në terma të trashë mund t'i quajmë baballëk, del kryetari i opozitës dhe sulmon egërsisht prokurorinë e vendit. Është shumë e thjeshtë. Skenari i parë u zbërthe: dy aktorë të drejtuar nga një regjisor dhe një skenarist, nuk e di në cilën skutë të egër apo në cilën parti janë regjistruar, kanë dalë tashmë me prova e me fakte, jo me aludimet tona, si të përfshirë në një konspiracion për para. Kaq e thjeshtë është kjo histori banale, e cila ka përmbatur mediet tona dhe diskursin politik, duke ndikuar në mënyrën sesi të rinjtë, fëmijët, gratë, burrat, pleqtë e këtij vendi e shikojnë politikën. Politika nuk është një profesion kriminal. Politika është një profesion i

lartë, i cili synon që mjetet t'i përdorë për të ndryshuar të ardhmen dhe për të bërë ligje si ky i sotmi, që përmirëson kushtet e jetesës së njerëzve; është një mundësi që njerëzit të bëhen bashkë për të ndryshuar realitetin e tyre dhe që politika të katandiset në një betejë të tërë marrjedhëniesh për telenovela të sajura, e theksoj, kriminale. Këtu duhet një reflektim i përgjithshëm. Duhet mbajtur përgjegjësi deri në fund. E vërteta për të dy skenarët e partisë babalokratike duhet të bëhet publike për të gjithë qytetarët. Duhet që në këtë rast prokuroria dhe gjykata të lihen të qeta të bëjnë detyrën e tyre. Duhet që t'u besojmë institucioneve të shtetit. Duhet që ta kthejmë politikën dhe opozitën në binarët e arsyes e të ligjshmërisë dhe duhet që kësaj peshë të rëndë për shpinat e qytetarëve, një barrë e cila është ngarkuar në shpinën e tyre nga politika pa kokë e një opozitë të çoroditur, t'i jepet fund dhe të kthehemi te ndryshimet ligjore për sigurinë në burgje, te ndryshimet ligjore për pikat e bastit, te ndryshimet ligjore për sigurinë dhe regjistrimin e fëmijëve, te politikat më të mira për fermerët, për arsimin dhe luftën ndaj injorancës dhe prapambetjes. Këto çështje e kthejnë vëmendjen nga politika e telenovelës te politika reale e terrenit.

Faleminderit të gjithëve!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Vasilika Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e ka deputetja Milva Ekonomi.

Të përgatitet deputetja Vilma Bello.

Milva Ekonomi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj se të gjithë ne, por edhe kolegët opozitarë, të cilët nuk janë sërish sot në këtë sallë, e konsiderojmë arsimin një të mirë publike dhe si themel i ndërtimit të së ardhmes, aty ku mbështetet progresi dhe integrimi ynë europian. Gjithsesi, thjesht konsiderimi i tij nuk është i mjaftueshëm. Duhet të punohet çdo ditë për përmirësimin e modernizimin e kësaj shtylle të shoqërisë dhe duhet ta kemi në qendër të vëmendjes. Ndaj, edhe kjo na diferencon ne nga kolegët opozitarë.

Reformat e ndërmarra në mandatin e parë të qeverisë socialiste shënjestruan ndryshime në disa pjesë të sistemit arsimor, por në çdo cikël

patën një vëmendje të veçantë. Motoja e ndryshimit vinte në qendër të vëmendjes nxënësin dhe studentin, si zotërues të kompetencave dhe të ekonomisë së dijes, por që të arrihej kjo duhet të bëheshin disa ndërhyrje. Duhej të ndërhyje te godinat ku zhvillohej mësimi, te mënyra si shpërndahej dija dhe nxënia efikase për çdo nxënës.

Le të flasim për arsimin parauniversitar, sepse atë e konsiderojmë shumë të rëndësishëm edhe për faktin tjetër se aty themelohet dija bazike e çdo individi të shoqërisë. Gjatë këtij mandati u rikonstruktuan 24 shkolla të arsimit bazë dhe 8 të arsimit të mesëm me një vlerë prej 2,2 miliardë lekësh. U kompletuan me laboratorë të Kimisë, Fizikës dhe Biologjisë 50 shkolla me një vlerë prej 70 milionë lekësh. U shpërndanë 20 milionë lekë libra artistike dhe u sistemuan shumë terrene sportive nën moton “Shkolla qendër komunitare”. Të mos harrojmë se gjatë këtij viti do të rehabilitohen edhe 52 terrene sportive në të gjithë vendin. Mësuesit po punësohen sipas parimit të dijeve dhe eksperiencës. Për këtë po ndihmon portali “Mësues për Shqipërinë”, i cili mundëson punësimin sipas kompetencave dhe eksperiencës dhe në bazë të një gare të ndershme për 5000 mësues në rang vendi. U sigurua transporti për 12 mijë e 56 mësues në zonat e largëta me një fond prej 307 milionë lekësh. Trajnimi i mësuesve u shtri gjatë gjithë vitit.

Ky vit shkollor solli edhe një risi tjetër: një administrim më të mirë të burimeve njerëzore në çdo shkollë, duke lejuar shpërndarjen e ngarkesës arsimore sipas numrit të nxënësve dhe profilit të mësuesve, duke i dhënë mbështetje programit “Bëjmë detyrat e shtëpisë”.

Planifikimi dhe administrimi i burimeve njerëzore bëri që mësuesit e përkushtuar në 19 shkolla të vendit të vazhdojnë me sukses *e-Twinning*. Shkolla e drejtorëve nuk erdhi vetëm si një risi legjislative, por brenda pak muajsh u bë një realitet i prekshëm, ku çdo drejtor dhe nëndrejtor i shkollës do të aftësohet me kompetenca për ta kryer edhe më mirë administrimin e institucionit të tij.

Edhe për nxënësit u realizuan disa lloje mbështetjesh, por, mbi të gjitha, ishte përmirësimi i kurrikulës mësimore duke ndjekur modelet më të mira europiane. Përmirësimi i rezultateve të vlerësimit PISA dhe TIMS tregoi

që Shqipëria kishte bërë progres, duke rritur me 21 shkallë nxënien në shkencat ekzakte në vend.

Marrja e teksteve falas për 189 mijë e 850 nxënës gjatë këtij viti, nga të cilët 125 mijë e 846 janë të klasave të para deri në të katërt, është një premtim i mbajtur. Ulja e numrit të klasave kolektive në 384 dhe kalimi në klasa normale i 2825 nxënësve është, gjithashtu, një premtim i mbajtur. Ofrimi i transportit për 30 mijë nxënës me një fond prej 363 milionë lekësh vazhdon. Rritja e mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar me 700 mësues, duke lejuar të asistohen 3500 nxënës me aftësi ndryshe, është një premtim i mbajtur.

Dy ditë më parë qeveria ndërmori një nismë për zbatimin e programit “Oficerët e sigurisë në shkollat e vendit”. Siç e dimë, fillimisht ky program u pilotua në 15 shkolla dhe nga ky pilotim pati rezultate të kënaqshme për mënyrën sesi operojnë këta policë në shkolla, në komunitetin e prindërve, dhe sesi komunikojnë ata me nxënësit. Ky program po shtrihet në 150 shkolla të vendit, kryesisht në gjimnaze, duke lejuar punësimin e 150 oficerëve të sigurisë. Ky program do të përmirësojë kushtet e mësimdhënies dhe ne po ndërmarrim reforma të vazhdueshme. Gjithsesi, është e nevojshme që nxënësi në shkollë të ketë ndjenjën e sigurisë që programi të ketë më shumë impakt. Oficeri i sigurisë nuk është një polic, por një kujdestar, i cili ka si detyrë të posaçme: rolin e ndërmjetësimit midis fëmijëve, mësuesve dhe prindërve dhe është një vëzhgues i veçantë. Avantazhi i një oficeri policie është që të krijojë siguri për shkollën, por edhe të bashkëpunojë me psikologun për të garantuar një shëndet më të mirë të nxënësit, si dhe për të mos lejuar shpërndarjen e lëndëve narkotike brenda shkollës.

Ju e dini se qeveria ka ndërmarrë një masë tjetër: heqjen e celularëve plotësisht nga ambientet e shkollave. Kjo vlen si për nxënësit, ashtu edhe për mësuesit.

Që nga data 31 dhjetor në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk do të lejohet asnjë pikë basti, asnjë kazino pranë qendrave të banuara. Një ndryshim i tillë do të sjellë zgjidhjen e një problemi të madh social edhe për nxënësit e shkollave të mesme.

Në fakt, ne sot po diskutojmë një projektligj, për dhënien e shtetësisë personave pa

shtetësi, i cili është shumë i rëndësishëm, sepse siguron më shumë vëmendje për fëmijët.

Unë jam anëtare e grupit “Miq të fëmijëve” dhe i kam ndjekur nga afër të gjitha tryezat e organizuara në Kuvend nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, zotit Ruçi, ku disa shoqata, por edhe programi i Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e refugjatëve, UNHCR-ja kanë bërë një analizë për hartizimin e personave pa shtetësi në të gjithë Shqipërinë. Në fakt, ky ndryshim legjislativ është një risi, sepse 1031 persona, nga të cilët më shumë se 96% janë fëmijë, do të përfitojnë nga kjo skemë. Kjo është një vëmendje e shtuar për të gjithë fëmijët në Republikën e Shqipërisë, ku, përveç sigurisë, ne u japim atyre mundësi të ndjekin shërbime publike pa pagesë në shëndetësi dhe në arsim. Vëmendja e qeverisë është shtuar për të dhënë një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, duke lejuar që në shkollat shqiptare të ketë më shumë siguri në momentin kur mësojnë dhe të ndihen të mbrojtur nga të gjitha rreziqet që mund të vijnë nga jashtë oborrit të shkollës.

Ju faleminderit! Besoj se do ta votojmë unanimisht këtë ndryshim në projektligjin që është prezantuar.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Fjalën e ka deputetja Vilma Bello.

Më pas ka kërkuar fjalën zëvendëskryeministrja, Senida Mesi.

Vilma Bello – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sigurisht, diskutimi im, edhe si anëtare e grupit “Miq të fëmijëve”, duhej të ishte fokusuar te projektligji për gjendjen civile, që zgjidh problemin e shtetësisë për 1031 fëmijë, për të cilin koleget e mia deputete folën para meje. Si deputete e këtij parlamenti, si një prej deputeteve të PS-së, dhe si deputete e një qyteti të mrekullueshëm me njerëz të mrekullueshëm, si Vlora, nuk mund të qëndroj indiferente ndaj të gjitha ngjarjeve të stisura në vazhdimësi, por të intensifikuara së fundi nga opozita. Në kohën kur opozita ulërin, duke përzier vazhdimisht çorbën e gatuar nga ajo vetë, ne vijojmë rrugën tonë, sepse ne, njësoj si të gjithë shqiptarët, nuk kemi asnjë minutë kohë për të humbur, duke mos rënë në batakun e llumit, në të cilin opozita zhytet çdo

ditë, në zvarritjet e vazhdueshme për të na servirur shpifjet dhe çuditë e radhës, apo me keq akoma, fabrikimet e tyre brenda në SHQUP si të vërteta. Ata, edhe pse ndoshta as vetë nuk i besojmë tashmë, vijojnë t'i përsëritin aq shumë me idenë se ato mund të qëndrojnë pranë ndonjë mendje të çoroditur, sepse pranë ndonjë zemre shqiptari nuk ndodh kjo. Opozita e ka zgjedhur këtë si të vetmen rrugë për të ardhur në pushtet, por pushteti vjen nëpërmjet votës dhe shqiptarët na kanë besuar ne. Ndërsa paroditë e tyre teatrale vijojnë në seritë e tyre pa ndonjë rend logjik, ne vijojmë me përmbushjen e detyrimeve tona, për të cilat jemi zgjedhur dhe jemi besuar nga shqiptarët.

Ajo që dua të besoj se na bashkon të gjithë, maxhorancën dhe opozitën e munguar, është çështja e arsimit, si një e mirë publike, me ndikim shumë të madh në zhvillimin e një vendi. Reformat e shumta në arsim, të nisura që në mandatin e parë dhe mjaft ndjeshëm në të dytin, si: dhënia e teksteve falas për rreth 190 fëmijë nga klasa e parë deri në klasën e katërt, nismë e cila do të vazhdojë më pas në klasën e pestë dhe, deri në përfundim të mandatit, për të gjithë fëmijët e sistemit arsimor parauniversitar deri në klasën e 9-të; tekstet dhe kurrikulat me të cilat studiojnë tashmë fëmijët tanë; rritja e numrit të mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi ndryshe në 700 të tillë; programi i shkollës së drejtorëve, si një institucion që do të prodhojë drejtues të aftë e dinjitozë për drejtimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, e kanë bërë arsimin dhe të gjithë përbërësit e tij më me vlerë dhe më dinjitoz.

Vëmendja e programit qeverisës për arsimin edhe në Bashkinë e Vlorës ka qenë dhe është mjaft e madhe. Vetëm vitin që vjen do të ndërtohen 5 shkolla, 1 kopsht dhe 6 terrene sportive. Kjo tregon një vëmendje të jashtëzakonshme për cilindo qytet në cilindo bashki në Shqipëri, dhe kam kënaqësi ta them këtë gjë edhe për qytetin tim.

Vendimi i fundit i qeverisë për praninë e oficerëve të sigurisë në shkollat tona, sigurisht, është një nga nismat më pozitive dhe më të kërkuara, si një nga elementet thelbësore të parandalimit të dukurive negative brenda dhe jashtë mjedisve të shkollës. Episodet e dhunës, përdorimet e substancave narkotike, një fenomen shqetësues ky i bartur në vite, apo edhe dukuria e

bullizmit, e shfaqur ndjeshëm në mjediset arsimore, kanë qenë shqetësime prezente pothuajse në të gjitha këto institucione dhe janë shfaqur në një formë apo në një tjetër. Nëpërmjet kësaj nisme, kjo gamë problematikash me pasoja të ndjeshme në shkolla, shtronte domosdoshmërinë dhe detyrimin për t'u garantuar fëmijëve siguri maksimale. Pa dyshim, nisma gjen mbështetjen e stafëve pedagogjike, prindërve dhe komunitetit, pasi siguria e fëmijëve tanë vjen në plan të parë. Gjithashtu, kjo lehtëson edhe punën e mësuesve, të cilëve hera herës u është dashur t'i largohen misionit të tyre të mësimdhënies për të siguruar fëmijët. Për herë të parë kjo domosdoshmëri do të konkretizohet siç duhet.

Një tjetër nismë, që do të zbatohet, është heqja dhe përdorimi i celularëve në shkolla, si një mekanizëm që ndihmon punën e përditshme të nxënësve dhe të mësuesve.

Nga ana tjetër, vendimi që më 31 dhjetor të mbyllet plotësisht pikat e basteve dhe të salloneve të lotove sportive, po ashtu ishte një domosdoshmëri dhe një vendim për t'u përshëndetur. Nisma do t'i japë zgjidhje përfundimtare një problemi me impakt mjaft të gjerë social, pasi realiteti ka treguar se mjedise të tilla janë vatra të gjenerimit të krimit, ndërsa nga viti në vit është konstatuar një rritje e ndjeshme e personave me varësi të plotë ndaj aktiviteteve të tilla, pasoja të cilat nuk i vuajnë vetëm ata, por e gjithë shoqëria.

Nga ana tjetër, bashkëpunimi me prindërit për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Prindërve, do të forcojë partneritetin dhe përfshirjen e tyre në të gjitha aktivitetet e institucioneve të arsimit parauniversitar. Jemi në rrugën e duhur për ta vazhduar ndryshimin, për të nxitur ndryshim pozitiv dhe frymë besimi në të gjithë angazhimin tonë qeverisës. Duke përmendur të gjitha këto nisma pozitive dhe të gjitha ndryshimet pozitive që kemi ndërmarrë dhe kemi sjellë jo vetëm për arsimin, por edhe për nisma të tjera në çfarëdolloj fushe, ju ftoj që së bashku me to ta votoni këtë projektligj, të cilin e ceka pak në fillim, sepse është një projektligj në favor të së mirës dhe ndryshimit pozitiv në shoqërinë shqiptare.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bello!

Fjalën e ka zëvendëskryeministrja, Senida Mesi.

Të përgatitet deputetja Elona Gjebrea.

Më pas deputetja Elena Xhina.

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria shqiptare është angazhuar për të përmirësuar mirëqenien e çdo qytetari në vend. Një nga reformat më të rëndësishme, e cilat lidhet edhe me ligjin që kemi në shqyrtim, që ka të bëjë me përmirësimin e aksesit, rritjen e cilësisë dhe transparencës, është ajo për shërbimin publik. Në lidhje me përmirësimin e shërbimeve, kjo nuk është e vetmja reformë dhe e vetmja iniciativë e qeverisë shqiptare, pasi duam të kemi edhe shërbime të tjera që të kenë në qendër, së pari, qytetarin dhe, së dyti, të ulin korrupsionin. Në këtë kuadër, kemi punuar dhe vazhdojmë të punojmë për lehtësimin e barrës administrative dhe të burokracisë, që qytetarët dhe bizneset shpeshherë kanë, perceptojnë dhe marrin në zyrat e institucioneve tona publike. Edhe propozimi i sotëm për ndryshimin e ligjit nr. 10129 "Për gjendjen civile", është në linjë me lehtësimin e këtyre procedurave.

Ky projektligj propozon lehtësimin e regjistrimit dhe çregjistrimit nga regjistri i gjendjes civile, konkretisht lehtësimin e procedurave për deklarimet e lindjeve jashtë territorit të vendit; lehtëson regjistrimin e lindjes së fëmijëve në Republikën e Shqipërisë për ato raste kur akti i lindjes është i pamundur të mbahet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi dhe asnjëherë ky akt nuk mund të mbahet nga përfaqësi diplomatike apo konsullore shqiptare. Gjithashtu, në këtë projektligj parashikohet procedura që mundëson njoftimin e lindjes së fëmijës nga organet shtetërore pranë zyrës së gjendjes civile. Kjo procedurë i detyron spitalet apo maternitetet që të bëjnë njoftimin e lindjes në kohë reale në zyrat e Gjendjes Civile.

Një risi tjetër është rritja e numrit të deklaruesve të vdekjeve, me ndërhyrjen e tyre pranë zyrrave në gjendjen civile, pas përfundimit të afatit prej 10 ditësh, siç e parashikon ligji sot, me qëllim mbajtjen e aktit të vdekjes dhe çregjistrimin nga regjistri i gjendjes civile, që të mos ndodhin anomalitë që janë evidentuar në lidhje me çregjistrimin e personave të vdekur nga regjistri i gjendjes civile. Të gjitha këto masa

lehtësojnë marrjen e këtyre shërbimeve themelore nga ana e qytetarëve apo familjarëve të tyre brenda apo jashtë vendit.

Në kuadër të prioritetit të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme, së bashku me agjencinë “ADISA”, Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile po punojnë ngushtësisht për të krijuar paketa shërbimesh. Ky bashkëpunim është bërë për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve apo bizneseve që trokasën në zyrat dhe sportelet e shtetit dhe institucioni i parë duhet të marrë përsipër edhe barrën e komunikimit me institucionet e tjera, me qëllim që qytetari t'i jepet shërbimi përfundimtar.

Konkretisht, kemi nisur me paketën e lindjes për të lehtësuar nënat apo baballarët në procesin e regjistrimit të të porsalindurve, pagesën e barrëlindjes apo shpërblimin e bebes. Në rastin konkret, këto ndryshime do të lehtësojnë jo vetëm jetën e prindërve të rinj, por edhe do të materializohen shumë shpejt.

Ne jemi të vendosur që shërbimet tona të kenë në qendër qytetarin, të reduktojmë kohën e shërbimit dhe të lëvrimin të këtyre shërbimeve në favor të bizneseve dhe të çdo individi në Republikën e Shqipërisë. Shërbimet *online* janë një mënyrë shumë e mirë dhe synojmë t'i zgjerojmë, me qëllim që të minimizojmë korrupsionin në zyrat e shtetit dhe të rrisim transparencën.

Vëmendja jonë është ndaj çdo njeriu të zakonshëm të këtij vendi, prandaj, njëkohësisht, ne po punojmë edhe me administratën tonë publike, me qëllim që ta transformojnë rrënjësisht mënyrën, mentalitetin dhe metodën e punës me të cilën janë mësuar të punojnë deri tani.

Duam të reduktojmë dhe vazhdojmë të reduktojmë barrën e bizneseve në lidhje me lejet, licencat dhe dokumentet. Deri tani kemi reduktuar me 30% barrën e dokumenteve që kërkojnë marrjen e shërbimeve administrative. Po vazhdojmë të thellojmë procesin e derregulimit me 189 shërbime të tjera, të cilat i kemi në proces për t'i lehtësuar. Në proces janë 15 ligje, që do të eliminojnë licencat dhe leje, dhe 21 procedura të tjera, të cilat do të lehtësojnë barrën e biznesit dhe të qytetarëve, duke

rikategorizuar licencat nga niveli tre në dy, apo niveli dy në një, që është vetëdeklarimi dhe jo dorëzimi i dokumentacionit pranë zyrave tona.

Rivitalizimi i punonjësve të administratës publike nënkupton që ne të punojmë me ta në lidhje me zhvillimin e përhershëm dhe 360 gradë të tyre; të fuqizojmë dhe të përforcojmë procedurat e rekrutimit; të rregullojmë procesin e promovimit, të punojmë dhe t'i motivojmë që ta bëjnë punën e tyre më mirë. Aktualisht, për punonjësit e administratës publike ka vetëm dy rrugë: ose të punojnë me integritet dhe të motivuar për punën që kanë marrë përsipër, për t'i shërbyer çdo qytetari dhe çdo biznesi që vjen në zyrat e shtetit, ose të largohen nga administrata publike. Rrugë të mesme nuk ka.

Ndërkohë, në ofrimin e shërbimeve *online*, dua të ndaj me ju disa statistika, që për mua janë një revolucion. Aktualisht në sistemin e-Albania ka 774 shërbime informative elektronike, nga të cilat 575 prej tyre janë shërbime elektronike të pjesshme dhe 30% shërbime elektronike janë me vulë dixhitale, që nënkupton se realizimi i këtyre shërbimeve kryhet 100% *online*. Vetëm gjatë javës së parë të tetorit mbi 30 mijë certifikata familjare dhe personale janë gjeneruar nga portali e-Albania. Po të shikojmë statistikën e një muaji, në rastin konkret muajin e fundit, shator 2018, kemi mbi 2 milionë vizita në portalin e-Albania, 31 mijë përdorues të rinj, 25 mijë përdorues vetëm nga aplikacioni *mobile*, po ashtu 200 mijë certifikata personale, familjare apo nga akti i martesës janë gjeneruar *online*. Vetëm po të llogarisim këtë shifër me 100 lekë, që është kostoja e marrjes së një certifikate, ne jo vetëm i kemi kursyer kohë çdo individi në Republikën e Shqipërisë, por edhe lekë. Janë kursyer plot 20 milionë lekë të rinj për një muaj vetëm nga gjenerimi i 200 mijë certifikatave *online*. Janë gjeneruar 45 mijë vërtetime për pagesën e kontributeve nga portali *online* e-Albania; 17 mijë deklarime dhe pagesa kontributesh nga punëdhënësi; 10200 aplikime për leje ndërtimi nëpërmjet sistemit e-Albania dhe e-Leje; 10 mijë vërtetime, konfirmim gjendjeje aktive të mjetit. Kështu kemi plot shifra të tjera, që tregojnë se gjithmonë e më tepër portali e-Albania, sistemet *online* po funksionojnë dhe qytetarët shqiptarë po marrin shërbime 24 orë në ditë, kur të duan, pa pasur rëndësinë nëse është e shtunë apo e diel apo nëse

ju ka ardhur orari zyrtar i institucioneve publike për t'u mbyllur.

Për të rregulluar kuadrin e përgjithshëm dhe për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, Këshilli e Ministrave ka në proces aprovimin e Kartës së të Drejtave të Qytetarit; projektvendimin për standardizimin e shërbimit në sportele dhe projektvendimin për miratimin e manualit të etikës në ofrimin e shërbimeve publike në sportelet e të gjithë institucioneve shtetërore. Faktikisht, ky transformim kërkon jo vetëm vullnetin e qeverisë, por të të gjitha palëve, sidomos kërkon vullnetin dhe një trajnim të mirë të çdo punonjësi në administratën publike. Jo pa qëllim këtë javë filloi trajnimi për komunikim, etikë dhe kujdes ndaj qytetarëve për mbi 1500 punonjës që punojnë në administratën publike, kryesisht në sportele, pra në vijën e parë të shërbimit. Këto trajnime do të vazhdojnë edhe vitin që vjen, me qëllim që, së pari, të përmirësojnë qasjen dhe komunikimin me qytetarin.

Së dyti, të rregullojmë infrastrukturën dhe aksesin.

Së treti, proceset e brendshme, *backoffice*, duhet të riinxhinierohen, me qëllim që të krijohen ato komunikime dhe ato lehtësi të domosdoshme për qytetarët dhe për bizneset.

Faktikisht, vëmendja jonë nuk është te serialet me audiopërgjime, vëmendja jonë është te çdo qytetarë i zakonshëm i këtij vendi. Platforma e bashkëqeverisjes, task forca antikorrupsion deri tani po funksionon dhe i kthen përgjigje brenda 10 ditëve çdo ankese të çdo qytetari dhe biznesmeni. Gjithashtu, kemi ndërmarrë rreth 250 masa disiplinore, nga të cilat edhe ndjekje penale, për çdo punonjës të administratës publike, që nuk ka bërë detyrën për të cilën paguhet. Kemi marrë masa konkrete, që rrisin direkt sigurinë publike. Oficerët e sigurisë nëpër shkolla shënjestrojnë drejtpërdrejtë sigurinë e fëmijëve tanë. Mbyllja e kazinove dhe e lojërave të fatit synon dhe godet jo vetëm kriminalitetin, por zgjidh edhe një problem shumë të madh social ekonomik. Ne çdo ditë përmirësojmë me hapa konkretë jetën e çdo shqiptari.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Mesi!

Urdhëroni, zoti Velaj!

Fatmir Velaj – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Sapo më lajmëruan nga familja e poetit të madh shqiptar për ndarjen nga jeta të Fatos Arapit. Ky është një largim i parakohshëm për letërsinë shqipe, edhe pse në moshën 89- vjeçare; e kësaj penë të shquar të letërsisë shqipe, e poetit të madh, i cili ka qenë frymëzim për qindra e qindra njerëz të letrave dhe të poezisë shqiptare. Unë vetë kam qenë i frymëzuar nga poezitë e tij, ashtu si shumë të tjerë.

Ju lutem, në emër të familjes dhe në emër të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, ku unë jam anëtar, të ngrihem dhe të mbajmë 1 minutë heshtje!

Vasilika Hysi – 1 minutë heshtje.

I paharruar qoftë kujtimi i tij!

Të nderuar kolegë, fjalën e ka deputetja Elona Gjebrea.

Elona Gjebrea – E nderuar zonja drejtuese e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Paketa e projektligjeve që vjen sot për miratim ka një rëndësi të veçantë, pasi synon të forcojë sigurinë publike, si dhe të luftojë disa fenomene, që janë bërë shumë shqetësuese për shtetin dhe shoqërinë.

Tashmë është evidente edhe për publikun e gjerë se rritja e forcës goditëse të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese ka bërë që një numër i madh kriminelësh dhe personash të lidhur me krimin të përfundojnë aty ku e meritojnë. Po ashtu është e dukshme, dhe janë zbuluar mjaft raste, kur këta persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore kanë vijuar aktivitetin e tyre kriminal, edhe pse të izoluar. Me gjithë masat e shumta që janë marrë për forcimin e sigurisë në burgje, këta persona kanë mundur të sigurojnë lidhje të mjaftueshme për të komunikuar me bashkëpunëtorët e tyre në liri, madje të arrijnë deri aty sa të organizojnë veprimtarinë kriminale nga brenda burgjeve. Për këtë arsye nisma e fundit e Kryeministrit për të shtuar masat e kontrollit ndaj këtyre personave është shumë e rëndësishme dhe vlen të përgëzohet. Është e rëndësishme të mos lejojmë asnjë tentativë të riaktivizimit të grupeve kriminale, aq më tepër kur këto tentativa vijnë nga brenda burgjeve. Unë jam besimplot se

strukturat e Policisë së Shtetit dhe ato të Drejtorisë së Burgjeve do të jenë në lartësinë e duhur për të realizuar në praktikë këto masa që ne do të miratojmë sot.

Nga ana tjetër, vendosja e 150 oficerëve të sigurisë në shkolla është një hap tjetër domethënës për rritjen e sigurisë publike. Edukimi dhe mbrojtja e brezit të ri nga fenomenet negative, që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurinë e jetës së tyre, por edhe në formimin e tyre të përgjithshëm, është dhe do të jetë një prioritet i padiskutueshëm i maxhorancës sonë qeverisëse.

Pilotimi i këtij projekti përgjatë dhjetë javëve në pesëmbëdhjetë shkolla të vendit ka dhënë rezultate mjaft të mira dhe është një bazë shumë e mirë për ta shtrirë atë tashmë edhe në 150 shkolla të tjera. Oficerët e sigurisë do të kenë detyrë të mbrojnë fëmijët nga dhuna, lëndët narkotike, duhani, bullizmi, lënia e orëve të mësimi. Kjo vëmendje e shtuar po i kushtohet brezit të ri, si pjesë e krijimit të mundësive për t'i mbrojtur dhe për t'i edukuar ata.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, mbyllja e kazinove, qendrave të basteve dhe lotove pranë qendrave të banuara është një hap vendimtar për t'i dhënë zgjidhje një herë e mirë këtij fenomeni vërtet shqetësues për shoqërinë. Duke nisur nga data 31 dhjetor në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk do të lejohet të punojë më asnjë sallë apo pikë basti dhe asnjë kazino pranë qendrave të banuara. Një ndryshim i tillë do të ndikojë në zgjidhjen e një problemi të madh social, por do të ndihmojë edhe në luftën ndaj krimit të organizuar. Ky vendim është përshëndetur nga më shumë se 95% e shqiptarëve dhe po merr përditë mbështetjen dhe vlerësimin e qytetarëve, grupeve të interesit, komuniteteve fetare e më shumë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Muajt e fundit opozita, që edhe sot mungon në parlament, është përpjekur t'i japë forcë vetes, pas humbjes së thellë në zgjedhjet e vitit të kaluar dhe pamundësisë për të qenë kompetitive në politikën e brendshme, duke e mbushur hapësirën e informimit publik me një lumë akuzash dhe mashtrimesh kundër qeverisë dhe maxhorancës sonë. Vetë drejtuesit më të lartë politikë të opozitës pranojnë se nuk kanë asnjë mundësi ta marrin pushtetin me zgjedhje dhe po përpiqen, me të gjitha format, ta marrin atë në

tavolinë, duke baltosur punën e qeverisë dhe duke sajuar gjithfarë telenovelash për të vërtetuar diçka, që, në fakt, nuk ekziston, siç është lidhja e qeverisë me krimin. Po përdorin të gjithë arsenalin kinematografik për t'i treguar publikut një histori që nuk ekziston.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se lufta me krimin, në veçanti përballja me krimin e organizuar, është një sfidë që nuk mbaron as sot, as nesër, por është një përballje që do të vazhdojë dhe që, sigurisht, vështirësohet ditë-ditë, ashtu siç jemi të ndërgjegjshëm se masat për forcimin e sigurisë nuk janë asnjëherë të mjaftueshme. Gjithmonë do të ketë vend për të përmirësuar dhe për të ndryshuar diçka. Por ne jemi të bindur se kemi bërë dhe po bëjmë shumë më tepër për ta goditur krimin dhe për t'i prerë atij rrugët e financimit, sesa ata që sot na akuzojnë duke përdorur si aktorë telenovelash njerëz të krimit.

Ajo që me të vërtetë qytetarët e shohin përditë është angazhimi maksimal i qeverisë për të luftuar krimin e organizuar, trafiket e paligjshme dhe korrupsionin në vend.

Paketa që ne po diskutojmë sot është një tjetër dëshmi e qartë e asaj se kush është në krahun e së drejtës dhe përballë krimit dhe kush merret me fjalë e me spektakle boshe nëpër salla hotelesh.

Vëmendja jonë është e gjitha për qytetarët dhe jo për luftërat me mullinj të erës, ku kërkon të na tërheqë opozita. Ne do të vazhdojmë të mendojmë për qytetarët dhe sigurinë e tyre, duke mos toleruar askënd që do të shkelë ligjin.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Fjalën e ka deputetja Elena Xhina, e cila, ndër të tjera, ka qenë edhe relatorja e këtij projektligji në Komisionin e Ligjeve, ndaj do të doja ta falënderoja shumë për të gjithë angazhimin dhe punën serioze që ka bërë për përmirësimin e tij!

Elena Xhina – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot në seancë vjen për votim projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”. Ky projektligj vjen nëpërmjet dy

nismave, nisma e parë e Këshillit të Ministrave, ndërsa e dyta vjen nga një grup deputetësh, e cila, në fakt, përmban edhe ndryshimet më thelbësore dhe më të rëndësishme të këtij projektligji. Sot të dyja këto nisma na paraqiten si një tekst integral për miratim.

Ajo që dua të them sot, me zë të lartë, për të cilën dua të kem vëmendjen tuaj, është se ky projektligj, krahas ndryshimeve të tjera, u jep fund dhe zgjidhje problematikave madhore, që janë hasur tashtë prej vitesh në zyrat e gjendjes civile, pasi fëmijët, të cilët kishin lindur jashtë shtetit apo jashtë kufirit të Shqipërisë, prindërit e të cilëve kanë deklaruar emra të pasaktë, kanë qenë pa dokumentacion të rregullt apo nuk kanë pasur mundësi ekonomike që të paraqiteshin pranë zyrave të gjendjes civile apo të bënin gjykime jashtë kufijve të Shqipërisë, nuk arrinin t'i regjistronin fëmijët e tyre pranë këtyre zyrave, duke sjellë si pasojë pamundësinë e tyre për të qenë subjekte të së drejtës ose shtetas me të drejta të plota në qarkullimin civil.

Sipas procedurës aktuale ligjore, për të regjistruar një fëmijë të lindur jashtë vendit prindërit duhet të merrnin një certifikatë lindjeje, të përkthyer në formën e parashikuar nga ligji, të legalizuar, burokraci këto të cilat bënin që shtetasit që ishin në kushte varfërie dhe pamundësie ekonomike të mos i realizonin, më pas të bënin regjistrimin në zyrat e gjendjes civile.

Mosregjistrimi i fëmijëve në zyrat e gjendjes civile nuk është thjesht pamundësi për të kryer një veprim procedural, është diçka shumë më e madhe, shumë më e thellë, është mohimi i të drejtave themelore për këta fëmijë dhe si pasojë sjell faktin se ata nuk mund të jenë subjekte të së drejtës, nuk mund të mbrohen veçanërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, pamundësi për të gëzuar të drejtën e emrit, të mbiemrit; pamundësi për të gëzuar një sërë të drejtash themelore, si: e drejta për arsim, e drejta për të marrë shërbim shëndetësor, e drejta për t'u ndier të barabartë në vendin e tyre.

Mekanizmi ligjor që ky projektligj sjell sot u garanton këtyre fëmijëve të drejtën për nënshtetësi, pavarësisht nga statusi, dokumentacioni, veprimet e prindërve të tyre, duke siguruar akses ligjor të barabartë për të gjithë, madje duhet theksuar se pamundësia për t'u regjistruar akti i lindjes në zyrat e gjendjes

civile sjell edhe pamundësinë për të pasur nënshtetësi dhe për t'u quajtur nënshtetas në shtetin e caktuar.

Problematika e mësipërme u evidentua më qartë pas një marrëveshjeje të nëntorit të vitit 2011 mes organizatës jofitimprurëse TLAS dhe Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë, e cila njoftonte për çdo rast në ministri, kur pranë saj paraqiteshin shtetas që nuk kishin mundësi ekonomike apo fizike për të kryer procesin e legalizimit të dokumenteve. Ky ishte dhe vazhdon të jetë një shërbim ligjor falas, i mbështetur nga UNICEF-i dhe UNHCR-ja, që u ka shërbyer për shumë vjet mijëra përfituesve, të cilët ndryshe do të mbeteshin pa shtetësi.

Të dhënat flasin qartë se tashtë situata e fëmijëve të lindur jashtë vendit dhe të paregjistruar ka qenë në nivele shqetësuese. Organizata TLAS ose Klinika Ligjore Falas, të cilën dua ta falënderoj sot për kontributin e dhënë në promovimin e këtij projektligji, na informojnë se vetëm gjatë vitit 2017 kanë trajtuar me ndihmë juridike 631 raste të regjistrimit të lindjeve, nga të cilat 380 raste janë fëmijë të lindur në shtetin grek, ndërkohë që ka identifikuar 300 raste të tjera që nuk mund t'i zgjidhin procedurat e regjistrimit as në rrugë administrative, as nëpërmjet vendimeve gjyqësore.

Nisur nga kjo situatë është realizuar studimi "Hartëzimi i personave pa shtetësi në Shqipëri". Për periudhën shtator-dhjetor 2017, ka rezultuar dhe janë identifikuar 10031 persona pa shtetësi, nga të cilët 96,7% janë fëmijë, kurse 84% e tyre ndeshin pengesa për marrjen e shtetësisë për shkak të procedurave të regjistrimit të lindjeve pranë zyrave të gjendjes civile.

Nga këto të dhëna rezultojnë qartë se fëmijët janë, në mënyrë proporcionale, në rrezik për të ngelur pa shtetësi dhe se regjistrimi i lindjeve mbetet një aspekt kyç dhe problematik, i cili do ta zgjidhte këtë ngërç dhe do të sillte regjistrimin e këtyre fëmijëve në zyrat e gjendjes civile. Pra, në terma sasiorë, thuhet se fëmijët në Shqipëri janë 95 herë më vulnerabel për çështjet e shtetësisë se sa të rriturit. Vlen të theksojmë se regjistrimi i lindjes së fëmijës së lindur jashtë vendit, pranë shërbimit të gjendjes civile, çka sjell si pasojë që edhe ata të jenë subjekte të së drejtës, është një nga detyrimet që parashikon

për vendet anëtare Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

Ky projektligj, duke pasur në vëmendje parimin e interesit më të lartë të fëmijës, nëpërmjet një mekanizmi dhe instrumenti ligjor, i cili vepron në rastet kur akti i lindjes së fëmijës së lindur jashtë vendit është i paplotë ose i pasaktë, bën të mundur regjistrimin e tyre në regjistrin e gjendjes civile nëpërmjet vendimeve gjyqësore.

Vëmendje dhe rëndësi të veçantë, pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji, duhet të ketë ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për vërtetimin e faktit juridik të lindjes, pasi është e rëndësishme që ky projektligj të sjellë pasoja dhe të jetë efikas për qëllimin për të cilin ne po e sjellim sot në Kuvend: që është regjistrimi i fëmijëve të lindur jashtë kufijve të vendit.

Për këtë arsye nga ministria përgjegjëse duhet të përgatitet një plan monitorimi se si do të jetë ecuria e regjistrimit të këtyre vendimeve nga zyrat e shërbimit të gjendjes civile në mbarë vendin, me qëllim që të shmanget çdo abuzim i mundshëm.

Më tej, në vija të trasha, dua të theksoj disa risi që sjell projektligji.

Në nenin 11 të projektligjit është parashikuar një dispozitë kalimtare, me qëllim pezullimin e masës së gjobës për një periudhë gjashtëmujore. Aktualisht, kjo gjobë aplikohet ndaj shtetasve që nuk deklarojnë ndryshimin e vendbanimit brenda afateve që ka parashikuar ligji. Vlera e gjobës, e cila është rritur në vitin 2016 me ndryshimet e ligjit “Për gjendjen civile”, nuk ka sjellë efektet e pritshme në ndërgjegjësimin e shtetasve për deklarimin e ndryshimit të vendbanimit. Pezullimi për gjashtë muaj i aplikimit të kësaj mase administrative konsiderohet një mundësi a një shtysë tjetër, që këta shtetas të ndërgjegjësohen dhe të deklarojnë vendbanimin aktual, duke pasur këtu në konsideratë shtetasit që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk kanë pasur as informacionin e duhur për këtë masë ndëshkimore që parashikon ligji.

Gjithashtu, ky projektligj sjell ndryshime të ndjeshme për sa i përket çregjistrimit të personave të vdekur, duke u përcaktuar në këtë projektligj detyrim institucioneve përgjegjëse që të kryejnë procedura konkrete në këtë drejtim. Pra, barra e

çregjistrimit nuk i lihet vetëm qytetarit, por u ngarkohet edhe institucioneve që e kanë këtë përgjegjësi.

Si pezullimi i masës së gjobës për deklarimin e ndryshimit të vendbanimit, ashtu edhe formalizimi i çregjistrimit të personave të vdekur, do t’u vijnë në ndihmë jo vetëm subjekteve të interesuara, por do të japin kontribut edhe në drejtim të reformës zgjedhore, pasi do të kemi listën reale të zgjedhësve dhe adresat reale të tyre.

Së fundi, duke falënderuar të gjithë ata që kanë punuar për këtë projektligj, organizatat e shoqërisë civile, ekspertët, si dhe deputetët nismëtarë, ju ftoj ta votojmë atë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Xhina!

Fjalën e ka deputeti Nuri Belba. Të përgatitet deputetja Antoneta Dhima.

Nuri Belba – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, dua të falënderoj qeverinë shqiptare për paraqitjen e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”!

Miratimi i këtij ndryshimi i vjen në ndihmë një numri të konsiderueshëm emigrantësh shqiptarë, të cilët ndodhen, për shkak të rrethanave, jashtë vendit.

Për një periudhë të gjatë sfidat që lidhen me regjistrimin e lindjeve jashtë vendit janë kthyer në një problem për të gjithë emigrantët që jetojnë me familjet e tyre jashtë vendit. Këtu shpeshherë prindërit gjenden në pamundësi për të siguruar aktet e rregullta të lindjes, ku përfshihet edhe informacioni bazë i emrit të kërkuar nga autoritetet shqiptare për të regjistruar lindjet e tyre.

Procedura që është ndjekur deri tani, në zbatim të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, për të regjistruar një fëmijë të lindur jashtë vendit, është se prindërit duhet të marrin një akt lindjeje nga vendi ku ka lindur fëmija, që duhet të jetë i përkthyer në shqip dhe i noterizuar. Ky dokument duhet të vërtetohet nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Jashtme e vendit të huaj ose nga bashkitë, pasi verifikimi mund të ndryshojë nga një vend në vendin tjetër. Të gjitha këto kërkesa burokratike të kësaj procedure janë të tatueshme dhe shpesh të

pamundura për t'u përmbushur, veçanërisht për nënat pa dokumente që lindin në vende të huaja dhe që jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Shumë prindër nuk arrijnë t'i trajtojnë të gjitha këto pengesa burokratike, të lidhura me legalizimin e certifikatave të lindjes në vendet e huaja dhe kthehen ose deportohen në Shqipëri para se të marrin certifikatën në formën e kërkuar nga autoritetet shqiptare.

Nga ana tjetër, shumica dërrmuese e kësaj kategorie prindërisht nuk janë në gjendje të kthehen në vendin ku kanë lindur fëmijët për ta zgjidhur çështjen, si rrjedhojë fëmijët e tyre janë pa identitet dhe në rrezik pashtetësie.

Aktualisht, aktet e lindjes të lëshuara nga autoritetet e huaja, të cilat janë të paplota dhe të pasakta në elementet e tyre, shpesh refuzohen të njihen nga autoritetet shqiptare, mandej edhe nga gjykata shqiptare, duke vendosur që, përderisa akti ekziston dhe është me mungesa, ai duhet të rregullohet në shtetin që e ka lëshuar atë.

Ky projektligj synon të rregullojë në mënyrë përfundimtare këtë gjendje të krijuar, duke i dhënë fund kalvarit të gjatë të përpjekjeve të shtetasve dhe aktorëve të përfshirë në këtë proces zgjidhjeje.

Projektligji parashikon që në rastet kur akti i lindjes, i hartuar në një shtet tjetër, ka të dhëna të paplota, është kompetencë e gjykatës shqiptare të bëjë vërtetimin e faktit juridik të lindjes, me qëllim regjistrimin në zyrat e gjendjes civile. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor në të cilën ka vendbanimin prindi ose prindërit e fëmijës për të cilin kërkohet regjistrimi. Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për vërtetimin juridik të lindjes brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, duke thirrur në cilësinë e personit të interesuar zyrën e gjendjes civile. Nëse vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë ka ankim, Gjykata e Apelit shqyrton ankimin në dhomën e këshillimit brenda 30 ditëve nga data e depozitimit.

Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi i lindjes mund të bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore jashtë vendit.

Të nderuar kolegë,

Ky është një projektligj që u vjen në ndihmë të gjithë emigrantëve, që ndodhen jashtë vendit dhe kanë kaluar një kalvar të papërshkrueshëm për një periudhë 25-vjeçare. Po ashtu mund të them edhe për efektet ekonomike të tyre.

Si deputet i zonës së Prrenjasit, dua të ngre 2-3 shqetësime, por si fillim dua të falënderoj qeverinë "Rama" për mbështetjen që i ka dhënë bashkisë së Prrenjasit në mandatin saj të parë dhe në këtë mandat qeverisës, pasi kjo bashki është mbështetur me investime, të cilat e kanë ndryshuar dhe e kanë përmirësuar jetën e qytetarëve.

Në vijim të fjalës sime dua të përcjell disa shqetësime, që janë bërë prezente pranë zyrës të deputetit nga banorët e zonës së Prrenjasit, të cilën unë e mbuloj. Dua të paraqes shqetësimin e banorëve të fshatit Rrajcë, të bashkisë së Prrenjasit, për konfliktin e lindur ndërmjet banorëve të këtij fshati dhe një subjekti privat, i cili ka fituar të drejtën për të ushtruar aktivitetin e kultivimit të bimëve medicinale në vendin e quajtur fusha e Rryenit. Drejtuesit e bashkisë së Prrenjasit në përpjekjet e tyre plotë dhe në shkellje të ligjit kanë dhënë pëlqimin që subjekti i licencuar për kultivimin e bimëve medicinale ta ushtrojë këtë aktivitet në fushën e Rryenit, pa kryer më parë një dëgjuesë publike me banorët, të cilët duhej të njiheshin me projektin dhe me kushtet e implementimit të tij, për të pasur një investim të qëndrueshëm dhe të dakordësuar nga komuniteti.

Fusha e Rryenit, me një sipërfaqe 80 hektarë, është lënë nga banorët e fshatrave Rrajcë-Skënderbe dhe Rrajcë-Sutaj, si pjesë e pandarë ndërmjet tyre sipas ligjit nr. 7501, të vitit 1991, duke rënë dakord midis tyre për ta përdorur si kullotë për blegtorinë. Me fillimin e punës nga subjekti, ka filluar konflikti. Firma në fjalë ka bllokuar kullotën për blegtorinë, ku të dy këta fshatra kanë investuar me burimet e tyre financiare në zhvillimin e blegtorisë, si i vetmi aktivitet, ku mund të sigurojnë të ardhurat minimale për të mbajtur familjet e tyre.

I kërkoj drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura ta zgjidhë problemin, duke ndërmjetësuar për lidhjen e një marrëveshjeje me banorët, ku të përcaktohen detyrimet e firmës për ta lënë të lirë hapësirën për kullotë, si dhe mospengimin e subjektit privat në ushtrimin e

aktivitetit konform ligjeve dhe rregullave të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Të nderuar kolegë,

Duke parë rëndësinë e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”, i cili vjen në një kohë kur qeveria jonë ka ndërmarrë shumë reforma për të çuar përpara programin e saj të paraqitur para të gjithë shqiptarëve, pas marrjes së votëbesimit më 25 qershor, ju bëj thirrje ta votojmë këtë projektligj, i cili është në të mirë të të gjithë atyre që kanë pasur një nevojë disavjeçare për të.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Belba!

Fjalën e ka deputetja Antoneta Dhima!

Të përgatitet deputeti Bujar Çela.

Antoneta Dhima - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuara kolege deputete,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i paraqitur për shqyrtim, është propozuar nga një grup deputetësh sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ky projektligj i propozuar nga grupi i deputetëve vjen si një domosdoshmëri e rregullimit të situatës së fëmijëve të lindur jashtë vendit, veçanërisht të fëmijëve, prindërit e të cilëve jetojnë jashtë vendit në mënyrë të parregullt. Shpeshherë, këta prindër nuk mund të sigurojnë akte të rregullta të lindjes, ose marrin vetëm një njoftim lindjeje, i cili nuk përfshin informacionin bazë të kërkuar nga autoritetet shqiptare për regjistrimin e lindjes së fëmijëve të tyre. Sipas procedurës aktuale ligjore, për të regjistruar një fëmijë të lindur jashtë vendit prindërit duhet të marrin një certifikatë lindjeje nga vendi i lindjes dhe ajo duhet të jetë në formën e parashikuar nga ligji, të jetë akt i legalizuar, i përkthyer në shqip dhe i noterizuar. Ky dokument duhet të verifikohet nga Ministria e Jashtme dhe nga Ministria e Brendshme e vendit të huaj ose nga bashkitë. Verifikimi mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin. Pas përfundimit të këtyre procedurave, fëmija regjistrohet në zyrat e gjendjes civile në

Shqipëri. Kërkesat burokratike të kësaj procedure janë shpesh të pamundura për t'u përmbushur, veçanërisht për nënat pa dokumente, që i lindin fëmijët jashtë vendit dhe që jetojnë në kushte varfërie.

Projektligji u jep përfundimisht zgjidhje edhe rasteve të fëmijëve të lindur në një institucion shëndetësor brenda Republikës së Shqipërisë, por që nuk deklarohet dhe nuk regjistrohet në zyrat e gjendjes civile. Sipas projektligjit, ngarkohen me detyrimin për të ndjekur dhe, sipas rastit, për të kryer regjistrimin e fëmijëve, përveç personave të afërt, edhe njësitë e mbrojtjes së fëmijëve pranë bashkive, si dhe subjektet shtetërore e private, që kanë të drejtën të vërtetojnë lindjen.

Projektligji i propozuar nga ne u jep zgjidhje shqetësimeve të shtruara edhe nga disa organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare, si UNICEF-i dhe UNHCR-ja, si dhe nga ekspertët shqiptarë për çështjen e mosregjistrimit në vend të një numri të konsiderueshëm të fëmijëve.

Në tryezat e organizuara në Kuvend nga grupi “Miq të fëmijëve”, organizata TLAS na informoi se vetëm gjatë vitit 2017 ka trajtuar me ndihmë juridike 631 raste të regjistrimit të lindjeve, nga të cilët 380 kanë lindur në Greqi, ndërkohë që ka identifikuar edhe 300 raste të tjera, që nuk mund të zgjidhen as me procedura administrative dhe as me rrugë gjyqësore.

Nisur nga kjo situatë, TLAS-i me mbështetjen e UNHCR-së, realizoi studimin “Hartëzimi i personave pa shtetësi në Shqipëri” për periudhën shtator-dhjetor 2017.

U identifikuan edhe 1031 persona të tjerë pa shtetësi, nga të cilët 96, 7 % janë fëmijë. 84% e tyre ndeshin pengesa për marrjen e shtetësisë për shkak të procedurave të regjistrimit të lindjes dhe janë në pritje për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Gjatë diskutimit të kësaj problematike në Kuvend me grupin “Miq të fëmijëve” nga ne dhe nga ekspertët u arrit në përfundimin se kjo çështje kërkonte një zgjidhje ligjore.

Një vëmendje e shtuar e kësaj qeverie është edhe kujdesi për sigurinë në shkollë. Të gjithë e dime sa e rëndësishme është për nxënësit e cikleve të ndryshme shkollore një mjedis i sigurt shkollor. Një mjedis i sigurt, që garanton qetësi në procesin mësimor dhe në zhvillimin e orëve të mësimi, është po aq i rëndësishëm edhe për

prindërit, të cilët ua besojnë për orë të tëra fëmijët e tyre edukatorëve dhe mësuesve. Rritja e parametrave të sigurisë nëpërmjet mbështetjes dhe ndërveprimit ka qenë një ndër synimet kryesore të qeverisë shqiptare. Në këtë kuadër pak kohë më parë ka nisur të implementohet fillimisht në 15 shkolla nisma për oficerët e sigurisë në shkolla, e cila pritet të zbatohet në 150 institucione arsimore, kryesisht në ato të arsimit të mesëm. Një mjedis arsimor i sigurt është tepër i rëndësishëm për të shmangur fenomenet negative, si dhuna, përdorimi i substancave të ndaluara dhe bulizmi.

Shmangia e këtyre fenomeneve ka qenë në qendër të vëmendjes së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të Ministrisë së Brendshme. Gjatë 10 javëve, kohë kur u pilotua programi në fjalë, rezultatet kanë qenë të kënaqshme. Gjatë kësaj periudhe u parandaluan 80 situata problematike, ndër të cilat mund të përmendim 32 raste të konflikteve verbale dhe fizike mes nxënësve, 9 raste konfliktesh verbale nxënës-mësues dhe disa hyrje të paautorizuara në mjediset shkollore. Vendosija e oficerëve të sigurisë ka ardhur si një risi, e cila shumë shpejt ka gjetur zbatim, duke e rritur sigurinë jo vetëm në shkolla, por edhe në mjediset përreth tyre, duke siguruar përgjigje të shpejtë ndaj problematikave dhe çështjeve të ndryshme, madje edhe duke i zgjidhur ato.

Ndërsa synimi kryesor është pikërisht siguria, një nismë e tillë nxit edhe ndërveprimin e nxënësve e të rinjve me policinë, duke rritur besimin dhe komunikimin me të. Oficerët e sigurisë në shkollë janë burime të vlefshme të shkollave për krijimin e një mjedisi të sigurt në to, përmes ndërtimit të marrëdhënieve të forta dhe të qëndrueshme me nxënësit, me stafin e shkollës, me prindërit dhe me komunitetin. Ata janë të përgatitur dhe të trajnuar për të përmbushur rolin e tyre, madje të bashkëpunojnë me psikologët, të marrin pjesë në takimet me prindërit etj. Oficerët e sigurisë në shkollë janë një urë e mirë lidhëse midis policisë, shkollës dhe të rinjve, duke u cilësuar si partnerë dhe si këshillues të administratës së shkollës.

Mund të themi se oficerët e sigurisë në shkolla shërbejnë si një model rolesh pozitive për nxënësit dhe edukojnë vlerat e sistemit tonë ligjor.

Kazinotë dhe bastet sportive në qendrat e qyteteve ishin kthyer në një problematikë të madhe për të gjitha familjet shqiptare. Vendimi më i fundit i qeverisë, i cili do të hyjë në fuqi në fund të këtij viti, është lajmi më i mirë që qytetarët kanë dëgjuar gjatë këtyre ditëve. Ndryshimi që pritej të hynte në fuqi më 1 janar 2019, parashikonte të ndalonte vetëm kazinotë në qendrat e banuara. Me ndryshimet e reja, janë përshkallëzuar këto kufizime, duke përcaktuar përveç largimit të kazinove nga këto qendra, edhe ndalimin dhe mbylljen e plotë të salloneve dhe të pikave të basteve sportive. Një gjë e tillë do të thotë se, duke nisur nga 1 janari 2019 në të gjithë territorin e vendit, nuk do të lejohet të punojë asnjë sallon apo pikë bastesh, si dhe asnjë kazino, e cila deri sot operonte fare pranë qendrave të banuara, duke lejuar që aty të futeshin dhe të luanin edhe shtetas, të cilët ishin nën moshën e lejuar.

Ky ndryshim i rëndësishëm pritet të ndikojë pozitivisht në zgjidhjen e një plage të madhe sociale, e cila prekte familjet shqiptare. Ai do të luftojë fort edhe krimin e organizuar. Edhe pse arsyet ekonomike, siç janë 54 milionë dollarë taksa nga bastet në vitin e kaluar, apo punësimi që ky aktivitet gjeneron, është provuar tashmë se një pjesë të mirë të fitimeve të siguruar nga ky lloj aktiviteti sponsorizonte krimin e organizuar në vend.

Efektet e këtij vendimi pritet të ndihen gjatë ditëve të para të vitit të ardhshëm, atëherë kur shumë qytetarë do të ndihen më të lirë kur ecin nëpër rrugët e qyteteve ku jetojnë dhe të mos shohin më reklama dhe tabela orientuese të kazinove dhe pikave të basteve, që i shtynin t'i shpenzonin të ardhurat e tyre në këto pika, që, për hir të së vërtetës, duhet thënë se kanë lulëzuar pranë çdo qendre të banuar. Me vendosmërinë e palëkundur të kësaj qeverie për të përqendruar të gjithë vëmendjen te qytetarët e këtij vendi, kemi vijuar me lehtësi të reja të rëndësishme për sipërmarrjen, të cilat u materializuan në paketën fiskale të qershorit 2018.

Paketa e re fiskale, e hartuar për vitin 2019, sjell uljen e mëtejshme të ngarkesës fiskale, ashtu siç kishim premtuar.

Nga janari 2019 tatimfitimi për bizneset me të ardhura nga 8-14 milionë lekë do të jetë 3 herë

më pak. Nga 15%, që është aktualisht, do të ulet në 5%.

Me këtë masë mbi 91% e sipërmarrjeve në Shqipëri do ta kenë tatimfitimin 0-5%.

Sektori energjetik do të përjashtohet nga TVSH-ja për një gamë të gjerë të linjave teknologjike, të makinerive dhe të pajisjeve, me qëllim nxitjen e investimeve në fushën e energjisë diellore.

Ashtu si një vit më parë e mundësuar për turizmin dhe për agroturizmin, përsëri do të ofrojmë një normë të reduktuar të TVSH-së, prej 6%, për shërbimet e akomodimit, ushqimit apo veprimtarive të tjera, si dhe përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja me qëllim agroturizmin.

Në të njëjtën kohë ne do të finalizojmë së shpejti procesin e gjerë të konsultimeve për draftin e paketës fiskale për vitin 2019, në të cilën do të vazhdojmë të materializojmë të tjera lehtësi fiskale në interes të biznesit dhe të qytetarëve.

Në kushtet kur projektligji që propozon grupi i deputetëve, është në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit, të nderuar kolegë dhe kolege deputete, ju ftoj ta miratojmë atë!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Dhima!

Fjalën e ka deputeti Bujar Çela!

Të përgatitet deputeti Taulant Balla!

Bujar Çela – Përsëritet, zonja drejtuese e seancës!

Përsëritet kolegë që jeni në sallë!

Përsëritet zoti drejtor i Gjendjes Civile!

Unë besoj se me këto ndryshime ligjore, ju do të jeni edhe miku më i madh i fëmijëve, përveçse drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile.

Unë jam plotësisht dakord me këto ndryshime në ligjin “Për gjendjen civile”. Shpeshherë jemi dëshmitarë të këtyre problemeve nga kontaktet me qytetarë të ndryshëm, sepse një ndër ata jam edhe unë, që flas sot në këtë sallë. Ne kemi ikur nga gardhi i kufirit për një jetë më të mirë dhe jemi kthyer nga pika kufitare me fëmijët tanë, por pa dokumente; kjo gjë ka bërë që fëmijët të mos regjistrohen. Ka nga ata fëmijë, të cilët janë 10 vjeç dhe nuk kanë mundur të regjistrohen në gjendjen civile.

Me këto ndryshime ligjore unë qetësoj Jetnorin nga fshati Gjyshaj dhe shumë të tjerë, të cilët nuk kanë më nevojë që të marrin atë vulën e famshme apostile, për të bërë regjistrimin për marrjen e së cilës shpesh ata nuk mbajnë mend as maternitetin se ku u ka lindur fëmija.

Njëkohësisht, i them drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile që t’i trajnojë punonjësit e gjendjes civile për lehtësirat dhe aktet ligjore dhe nënligjore, që ata të mos bëhen barrierë, por të jenë sqarues të mirë të këtyre halleve, të cilët nuk po bëjnë ndonjë krim, por vetëm kanë shtuar popullsinë dhe duan t’i regjistrojnë këta fëmijë.

Duke përfituar nga rasti që nuk është Shalsi këtu dhe, meqë të gjithë kolegët parafolës dolën nga tema, edhe unë dua të përmend disa çështje të vogla. Cilat janë ato?

Në vazhdimësi të temës për gjendjen civile, ne aplikojmë për karta identiteti dhe për pasaporta te shoqëria “ALEAT”, e cila jo në të gjitha zyrat ka kushte të mira për qytetarët, që do të thotë hapësira, ngrohje dhe kondicionim.

Së dyti, dua të përsëritet punën e bërë nga Ministria e Arsimit, totalisht si ekip! Vetëm dje për herë të parë në komision ministria është ndier si ministre, sepse herët e tjera ka pasur nevojë të mbrohet nga ata që e sulmonin, të cilët nuk e duan as arsimin, as integrimin, as vetingun, por vetëm vazhdojnë prej muajsh të tërë të bredhin “kotec më kotec”, më falni për shprehjen: “hale më hale, për të gjetur “Babale”!

Qytetarët tanë në bisedat e tyre shprehin shumë qartë se kjo opozitë e ka mbaruar misionin saj politik. Qytetarët, votuesit e djathtë dhe ata tradicionalë, të cilëve kjo opozitë nuk u ka shërbyer asnjëherë, po presin me padurim votimet e ardhshme për t’iu treguar vendin që meritojnë në historinë e këtij kombi.

Dua t’i bëj thirrje Prokurores së Përgjithshme që të nisë hetimet për të gjithë këta shpifës, që po i nxijnë imazhin vendit tonë, sepse, nëse do ta kishte bërë ndonjëri prej nesh, në qeverisjen e Sali Berishës, do të ishte tërhequr zvarrë prej zhelesh drejt burgut, jo në gjykatë.

Faleminderit dhe ju ftoj të gjithëve ta votojmë projektligjin.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Çela!

Fjalën e ka deputeti Taulant Balla.

Me diskutimin e kolegut Balla mbyllet edhe lista e deputetëve të regjistruar, sepse besoj se nuk ka deputetë të tjerë, të cilët duan të flasin.

Më pas do të kalojmë në diskutimet në emër të grupit parlamentar.

Taulant Balla – Për të qenë strikt me procedurën, zonja drejtuese e seancës, më lejo të them se ky është një nga ato ligje që ka qenë i nevojshëm të miratohej prej kohësh, por, falë punës së mirë dhe bashkëpunimit të Kuvendit me qeverinë, sot ndreqim disa gabime të bëra prej shumë vitesh në Regjistrin e Gjendjes Civile të Shqipërisë.

Disa mijëra të vdekur nuk do jenë më në regjistër, sikurse edhe 8 mijë të tjerë, që nuk kanë qenë në regjistër, do të regjistrohen. Ky është një shërbim i shtuar, i cili ka munguar dhe i ka sorollatur qytetarët për vite me radhë në dyert e gjendjes civile apo në dyert e gjykatave.

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Më lejoni të them edhe dy fjalë për të gjithë këtë histori balte të pafund.

Dje kam pasur mundësinë të ndjek në rrugë juridike, në të njëjtën ditë, madje edhe në të njëjtën orë, përafërsisht dy procese gjyqësore: njërin me dhëndrin që Saliu i la partinë, Lulzimin, dhe tjetrin me dhëndrin natyral të Saliut, bashkëshortin e vajzës së tij; njërin në Gjykatën e Tiranës, tjetrin në gjykatën italiane. Ky i dyti bën fjalë për një akt të turpshëm të degjenerimit të familjes së ish-kryeministrit Berisha, ku, si çdo qytetar tjetër i këtij vendi, pasi po kthehesha nga një detyrë shtetërore në një vend europian, papritur e papandehur dhëndri natyral i Saliut më goditi në prezencë të bashkëshortes së tij. Dje në gjykatën italiane, gjyqtari italian nuk e pranoi ofertën e dhëndrit të Saliut për të paguar para ndaj meje për dëmin e shkaktuar, se këta janë mësuar të paguajnë para për këdo; paguajnë para për “Babalen” dhe për për kunatin e “Babales”. Gjyqtari italian vendosi dje se oferta që kishte bërë dhëndri i Saliut për 2 mijë euro të mos pranohej, por të bëhej një ofertë tjetër. Ndërkohë, në Gjykatën e Tiranës dhëndri tjetër i Saliut, ai i partisë, Lulzimi, një dhëndër që ia mori në qafë partinë, nuk u duk fare në dyert e gjykatës.

Mediet kanë njoftuar që nesër Lulzimi duhet të shkojë në prokurori për një kallëzim penal, ndër to, kallëzim i rremë, shpërdorim

detyre, shpifje, fyerje. Lulzimi nesër ka detyrimin që të shkojë në prokurori.

Dje në gjykatë, dua t’ju them, i bëra një kërkesë për procedurë gjyqtarit dhe i thashë: “Zoti gjyqtar, ju lutem, mos lini seanca në orën 09:00 të mëngjesit, sepse Lulzimi nuk e kap dot. Është shumë herët për Lulzimin të vijë në gjykatë në orën 09:00 të mëngjesit!” Këshilla ime për prokurorinë nesër është që mundësisht ta thërrasin pasdite, sepse paradite nuk e kap dot Lulzimi!

Unë nuk e di pse opozita sot nuk është në këtë sallë, sepse turi i hoteleve ka mbaruar, të paktën nga njoftimet e deritanishme nuk ka ndonjë njoftim për mbledhje të opozitës në ndonjë hotel, nga ato që ju ka mbetur ende pa shkëlur!

Opinionin publik u njoh para dy netësh edhe me një seri të re të “Babale thriller seria 3”. Janë aq të paafte, saqë janë zhytur në llucë dhe brenda në llucë vazhdojnë të llokoçiten me disa histori, që as Saliu nuk i beson më ato që bën Luli.

Dua t’ju them se për transmetimin, që gjoja serviri Salianji, i cili tashmë në medie është konfirmuar se është bërë në oborrin e SHQUP-it nga ish-drejtori i Policisë Bashkiake të Lulit, Partia Demokratike ende nuk thotë se kush është gazetari i radhës të videoja e radhës. Unë nuk di që drejtori i Policisë Bashkiake të Lulit apo i inspektoratit të ndërtimit të Lulit të ketë punuar ndonjë ditë gazetar. Në kushtet e kësaj tentative të përsëritur për të hedhur baltë nëpërmjet një videoje tërësisht me përmbajtje të pavërtetë, është e rëndësishme të ndaj disa fakte! Është fakt i njohur që kemi tre aktorë të përfshirë në “Babale 1”, Fredi Alizoti, Albert Veliu, i njohur si “Babalja”, dhe deputeti i Partisë Demokratike, Ervin Salianji. Të njëjtët persona, të ndodhur në hall, përpara mundësisë që ligji dhe forca e ligjit të jetë e barabartë për të gjithë, kanë bashkëpunuar dhe hodhën për opinion një video të re.

Unë nuk do të bëj më kallëzim, sepse kjo çështje ndodhet tashmë në duart e prokurorisë. Regjistrimi që ka prokuroria tregon qartë se në bisedat e tyre “Babalja” dhe Alizoti kanë pranuar se u janë ofruar nga Partia Demokratike nga 100 mijë euro për kokë për rolin e luajtur në videon “Babale 1”.

Fakt tjetër, në regjistrimin e siguruar nga prokuroria vetë Alizoti pranon, me gojën e tij, se

ka luajtur rolin e vëllait të ministrit të Brendshëm.

Nuk ka vend në Europë që të konfirmojë nga hetimi i prokurorisë se një parti është përfshirë në një puç, me video të falsifikuara ndaj një ministri të qeverisë. Kjo parti jo vetëm që duhet të vinte në Kuvend, por kryetari, ende në detyrë i kësaj partie, duhet të vinte të kërkonte ndjesë publike për përfshirjen e turpshme të një prej partive më të mëdha të këtij vendi, e cila në vitin 1992 ishte më e madhja dhe në vitin 2018 është në shkrije e sipër

Kontakti i tyre me Partinë Demokratike, sipas materialeve të prokurorisë, është deputeti koordinator i Lulzimit, Ervin Salianji, i cili ka qenë edhe personi që ka vënë në shërbim edhe gazetarin Jetmir Ollidashi. Është po aq i rëndë fakti, nga çfarë është bërë publike, se ky gazetar paskësh qenë pjesë e infiltrimit edhe nga SHISH-i. Kjo e bën edhe më të rëndë gjithë këtë histori puçi, ku në krye të saj është Partia Demokratike e Shqipërisë, dikur partia e idealeve të dhjetorit, kurse sot nuk di si t'ia vë emrin kësaj partie. Ndërkohë, edhe transmetimi i pretenduar për të hedhur poshtë provën përforcon ndryshimet e kësaj maskarade të dakordësuar midis një deputeti të Partisë Demokratike, nën hyqmin e Lulzim Bashës, dhe të dy personazheve.

Sot ju do të vazhdoni të lexoni të njëjtin lumë akuzash. Detyra e Partisë Demokratike, përballë qytetarëve shqiptarë, është që të distancohet zyrtarisht. Në të kundërt, Partia Demokratike do të mbajë një gjurmë të një njolle të rëndë jo vetëm për veten, por për të gjithë historinë e kësaj partie, për të cilën duhet ta pranojmë se në këta 28 vjet ka plot merita të shkëlqyera për sa i përket rrugës euroatlantike të Shqipërisë, por me Lulzim Bashën, me dhëndrin në krye të Partisë Demokratike, Sali Berisha i vuri vulën e turpit kësaj partie.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Balla!

Këtu mbyllet lista e deputetëve të regjistruar për të diskutuar.

Kalojmë te diskutimet në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputeti Ulsi Manja.

Të nderuar kolegë pas diskutimit në emër të grupit, do të kalojmë në votim, ndaj ftoj të gjithë kolegët të vijnë në sallë.

Ulsi Manja – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Këto karrige bosh janë shfaqja më e shëmtuar e një lufte për pushtet të një opozite, që është kthyer në karrocë dhe me një kryetar partie, që tashmë është diagnostikuar se vuan nga sindroma “Babale”.

Në fakt, “Babalja” shkoi me këmbët e tij te selia e PD-së, por tani që ka hallet dhe problemet e tij me drejtësinë, e ka kapur Lulzimi dhe nuk i ndahet. Një ditë po të harrojmë të merret me “Babalen”, është e sigurt që i duket se po e shkarkojnë si kryetar i PD-së. Në këtë lojë ka mbetur vetëm me Salianjin, sepse Alibeaj dhe Bylykbashi, si juristë, të cilët ia dinë kimetin hetimit dhe burgut, janë distancuar dhe u është tretur zëri me kohë, ndaj nuk e përmendim më historinë e “Babales”.

Përtej kësaj opozite mjerane, që është bërë qesharake në sytë e shqiptarëve, shumica jonë qeverisëse vazhdon të ndërmarrë masa dhe reforma që synojnë t’ua lehtësojë jetën shqiptarëve, duke shfrytëzuar votimin e ligjeve të rëndësishme me 71 vota, sepse ligjet që votohen me shumicë të cilësuar, pra ato që duan 84 vota, vazhdojnë të mbarten nga seanca në seancë për votim, sepse kjo opozitë e ka braktisur me kohë misionin që i kanë ngarkuar votuesit e saj. Por, nëse nuk reflekton shpejt, është e sigurt se do të braktiset nga këta votues që i kanë mbetur.

Projektligji që do të votojmë sot “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për gjendjen civile””, është një ndërhyrje ligjore, që do t’i japë fund një kalvari të gjatë burokratik për qindra e mijëra prindër shqiptarë, që kanë probleme me regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë vendit, ku prindërit e tyre janë emigrantë të parregullt apo janë rezidentë të rregullt në vende të huaja, por nuk kanë mundur të regjistrojnë fëmijët; kanë pasaktësi ose të dhëna të paplota në aktet e lindjes; për fëmijët e braktisur nga prindërit; kur prindërit nuk dihen, kur prindërit kanë vdekur në një aksident apo në fatkeqësi natyrore dhe ky ndryshim ligjor i jep zgjidhje.

Sot janë 8 mijë fëmijë të paregjistruar, të padukshëm juridikisht për shtetin, pikërisht për shkak të këtij vakumi ligjor, mirëpo opozitës sonë këto, në fakt, i duken gjëra të vogla. Për ta është më e rëndësishme USB-ja me filma

vizatimorë që shkarkon nga interneti Salianji sesa halli i mijëra qytetarëve shqiptarë emigrantë, por edhe brenda Shqipërisë që përfitojnë nga ky ndryshim ligjor.

Ky ndryshim ligjor sjell edhe një risi tjetër, që ka të bëjë me çregjistrimin e personave të vdekur në rrethana natyrale ose aksidentale. Problem me regjistrim kur lind, por është hall edhe të vdesësh, sepse nuk çregjistrohesh dot nga regjistrat e gjendjes civile edhe 100 vjet mbrapa. Janë plot 27 vjet që regjistrat e gjendjes civile nuk pastrohen dot nga personat e vdekur, të cilët vazhdojnë të jenë kapicë në listat e zgjedhësve.

Po ju them diçka sa për humor. Vajti një burrë 80 vjeç të votonte, mori fletën e votimit në dorë dhe pyeti një nga anëtarët e komisionit: “A votoi gruaja ime sot?” “Ma jep emrin ta verifikoj në listë”, i tha komisioneri dhe pasi e pa i tha: “Po, ka votuar në orën 08:30”. Plaku i tha: “Më raftë pika që nuk erdha të votoj më herët se do ta kisha takuar”. Komisioneri e pyeti: “Pse jeni divorcuar, nuk jetoni bashkë?” “Jo, - i tha plaku, - ajo ka 30 vjet që ka vdekur, por unë të vetmen mundësi për ta takuar kam vetëm kur vijnë zgjedhjet, sepse ajo vjen të votojë dhe ikën.”

Po ashtu, një ndryshim i rëndësishëm është edhe pezullimi i masës së gjobës për një periudhë kohore 6-mujore, për atë kategori personash që nuk kanë bërë akoma lidhjen e vendbanimit faktik me gjendjen civile. Masat ligjore të kësaj qeverie nuk mbarojnë vetëm me adresimin e këtyre problemeve, sepse mbyllja përfundimtare e kazinove dhe i të gjitha lojërave të fatit, pavarësisht nga emri, baste apo gara me kuaj, është një iniciativë ligjore që synon ta kthejë shoqërinë në normalitet dhe të mbrojë strukturën e shoqërisë dhe familjen nga shpërbërja dhe konflikti social.

Saliu dhe Luli as në ëndërr nuk e mendojnë një gjë të tillë, jo se kishin hallin e gropës që do të pësonte buxheti i shtetit, por kishin hallin e gropës së xhepit të tyre, sepse ishin dhe janë përfutjesit më të mëdhenj të industrisë së bixhozit në Shqipëri. Nga mbyllja e lojërave të fatit buxhetit të shtetit do t'i krijohet një gropë prej 54 milionë eurosh, që sigurisht do të përkthehet në rritje konsumi, por edhe sikur 154 milionë euro të ishte gropa në buxhet, pas 1 janarit 2019 ne do t'u kursejmë fëmijëve tanë dhe familjeve tona shfaqjen e shëmtuar të reklamave me drita të kazinove dhe të sallave të

basteve sportive me emra të çuditshëm dhe të të gjitha bastoreve, që kanë pushtuar katet e para të pallateve.

Pse nuk i mbyllët më përpara, pyesin me të drejtë njerëzit e ndershëm të këtij vendi. Ne do t'i kishim mbyllur me kohë, por nuk i mbyllëm dot, sepse nuk i kishim 71 vota. Aleatit tone, LSI-së, në mandatin e parë, t'i përmendje mbylljen e lojërave të fatit, fillonte avazin: do të iki sot, do të iki nesër nga qeveria, por, në fakt, e shporrët ju me votë. Sot që na dhatë 74 vota ne, si Parti Socialiste, urdhëro, ja ku e keni ligjin, nuk do të keni më as lojëra fati dhe as bixhozhane në çdo rrugicë e pallat.

Janë edhe shumë nisma të tjera që kemi ndërmarrë si shumicë kuvendore, që kanë të bëjnë me sigurinë në shkolla, në burgje, por edhe ndryshime të rëndësishme të Kodit Penal, por që, për fat të keq, presin votën e opozitës, sepse nuk i bëjmë dot me votat tona dhe opozita po i mban peng.

Duke u kthyer edhe një herë te projektligji për disa ndryshime në ligjin e gjendjes civile, i ndryshuar, dua të falënderoj qeverinë për nismën, grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve” dhe personalisht Kryetarin e Kuvendit, zotin Ruçi, për angazhimin e tij personal në miratimin e këtyre ndryshimeve, zonjën Hysi, si propozuese në emër të grupit të deputetëve, të gjithë kolegët pa dallim, ekspertët e TLAS-it dhe të gjithë përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, që u përfshinë në diskutimin e këtyre ndryshimeve të rëndësishme në ligjin e gjendjes civile, që zgjidh në mënyrë të konsiderueshme shqetësimet disavjeçare të prindërve dhe të familjeve shqiptare. Për të gjitha këto arsye, ju ftoj, të nderuar kolegë, t'i votojmë pa vonesë këto ndryshime ligjore, që sigurisht nuk i zgjidhin të gjitha problematikat në lidhje me gjendjen civile, por janë një tregues i qartë i vullnetit tonë për të qenë në krah të qytetarëve.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Manja!

Ju falënderoj edhe për mbështetjen!

Meqenëse të pranishëm në diskutimin e këtij projektligji janë përfaqësues të UNHCR-së dhe të UNICEF-it, do të doja t'ju falënderoja ju dhe gjithë ekspertët për angazhimin dhe mbështetjen që i keni dhënë Kuvendit të Shqipërisë në hartimin e këtyre ndryshimeve!

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 11 TETOR 2018

Të nderuar kolegë, 5 minuta pushim dhe më pas do të kalojmë në votim!

Me këtë çështje mbyllet diskutimi në parim për këtë ligj.

(Drejtimin e seancës e merr zoti Gramoz Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Rifillojmë seancën.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

73 deputetë janë prezentë.

Fillojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”.

Projektligji kërkon për miratim shumicë të thjeshtë votash.

Meqenëse komisioni përgjegjës i ka shqyrtuar të dyja nismat së bashku dhe ka dalë me një variant integral, në votim do të votohet teksti integral i propozuar nga komisioni.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

73 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndiqet e njëjta procedurë votimi nga neni 6 deri te neni 27.)

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Ju njoftoj se sot u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila diskutoi drafprogramin e punës së Kuvendit dhe draftkalendarin 3-javor për periudhën në vijim. Siç dihet, opozita nuk mori pjesë në punimet e Kuvendit, për pasojë, në mbështetje të nenit 26, pika 6, dhe nenit 27, pika 4, të Rregullores, e hedhim në votim.

Kush është dakord me programin?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me kalendarin?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Programin dhe kalendarin 3-javor të punimeve të Kuvendit do t'i gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit.

Projektvendim “Për zgjedhjen e një anëtari të bordit të Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”.

Në mbështetje të ligjit nr.10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, anëtari i bordit në këtë rast emërohet nga Kuvendi në bazë të propozimit të Konferencës së Rektorëve.

Konferenca e Rektorëve ka propozuar sipas ligjit tri kandidatura për vendin vakant të bordit dhe konkretisht: zotin Alfred Lako, zotin Peter Saraçi dhe zotin Bajram Gjishiti.

Komisioni përgjegjës, që në rastin konkret është Komisioni i Ligeve, pas zhvillimit të seancave dëgjimore dhe pas vlerësimit të kushteve, kriterëve ligjore dhe meritës së çdo kandidati, ka vendosur t'i propozojë seancës plenare kandidaturat e mëposhtme:

Alfred Lako dhe Peter Saraçi.

Do të bëhen dy votime, një për secilin me elektronikë.

Votimi është i fshehtë.

Hapet votimi me elektronikë për zotin Alfred Lako.

Mbyllet votimi.

71 vota pro, 2 kundër, asnjë abstenim.

Hapet votimi me elektronikë për zotin Peter Saraçi.

Mbyllet votimi.

4 vota pro, 20 kundër, 49 abstenime.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 11 TETOR 2018

Sipas votimit të kryer, fiton për të qenë anëtar i bordit në vendin vakant zoti Alfred Lako.

Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, i bartur nga seancat e mëparshme, edhe sot nuk kalon për votim për mungesë kuorumi.

Edhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nuk kalon për votim për mungesë kuorumi.

Këtu mbyllet seanca.

Seanca tjetër do të njoftohet.

Faleminderit!

(Seanca u mbyll në orën 13:30.)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin
Alket Hyseni

Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri